

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5673  
E premte, 11 janar 2019  
çmimi 0.40 €

## Rimilitarizimi i Ballkanit

IFAQE 10-11

Prof. dr.  
Blerim REKA



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", HYSNI GUCATI IFAQE 4-5

## Të bashkëpunojmë me drejtësinë për hir të shtetit

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, ka ftuar veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të bashkëpunojnë me drejtësinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Gjykata Speciale është raciste, por për të mirën e shtetit duhet të bashkëpunohet me këtë institucion. Megjithatë, Gucati nuk e ka përjashtuar mundësinë e organizimit të protestave për ta kundërshtuar këtë gjykatë. "Por, për momentin, rruga dhe protesta nuk na konvenojnë. Mirëpo çdokush duhet ta dijë se edhe durimi i veteranëve të UÇK-së e ka një fund", ka thënë Gucati. Ai ka treguar se OVLUÇK-ja është e informuar nga Ministria e Drejtësisë për gjithë procesin



### AKTUALE



**INSTITUCIONET ARSIMORE  
TË KOSOVËS NË GREVË NGA  
14 JANARI** F.7

**KURTI TAKOHET ME  
AMBASADORIN FRANCEZ,  
THOTË SE VENDI DUHET TË  
SHKOJË NË ZGJEDHJE TË  
REJA** F.7

## Meta dhe Rama përplasen për ministrin e emëruar, Gent Cakaj

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka refuzuar të enjten emërimin e Gent Cakajt në postin e ministrit të Jashtëm, i propozuar nga kryeministri Edi Rama, në kuadër të ristrukturimit të Qeverisë. Meta ka thënë se Cakaj ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative dhe shtetërore. Ndërkaq kryeministri Rama ka theksuar se vendimi i presidentit është "jo vetëm antikushtetues, por edhe i turpshëm" IFAQE 3



**Maasi: Duhet  
ta mbajmë  
premtimin për  
liberalizimin e  
vizave për  
Kosovën** IFAQE 3

**STUDENTËT PROTESTOJNË,  
KËRKOJNË LIBERALIZIMIN E  
VIZAVE** F.6

### EKONOMI

**GLPS-ja: RITJIA E NUMRIT TË  
KËSHILLTARËVE, ABUZIM ME  
BUXHETIN E KOSOVËS** F.9

**JAPONIA E INTERESUAR TA  
FINANCOJË PROJEKTIN  
'KOSOVA E RE'** F.9



### SPORT

**DRENICA HUAZON KATËR  
LOJTARË NGA FERONIKELI** F.20

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## Studentët vazhdojnë protestën brenda fakulteteve

**TIRANË, 10 JANAR** - Studentët e universiteteve publike në Tiranë vazhduan edhe të enjten protestën e tyre me 8 kërkesa ekonomike dhe akademike. Ata të enjten protestuan në mjediset e brendshme të disa fakulteteve, ku studimet janë ndërprerë qysh prej fillimit të dhjetorit. Në disa fakultete u bllokuan hyrjet e ndërtesave dhe protestat vazhdojnë nëpër

korridore. Ata shprehen se do të qëndrojnë aty deri në zgjidhjen e kërkesave të tyre nga ana e Qeverisë.

Studentët pohojnë se bojkoti i studimeve vazhdon masivisht dhe numrat e ulur të pjesëmarrjes në protesta vijin thjesht prej faktit se shumë studentë nuk po kthehen në kryeqytet pas festave të fundvitit. Ata shprehen se nuk besojnë që kërkesat e tyre

do të plotësohen, ndaj po e përshkallëzojnë protestën. Protesta e mijëra universiteteve nisi ditët e para të dhjetorit dhe vazhdon prej më se një muaji me tubime para Ministrisë së Arsimit dhe kryeministrit. Qeveria i quan të plotësuarat kërkesat e tyre me 11 vendimet e fundit, duke siguruar përgjysmimin e tarifave dhe lehtësira të tjera, por studentët mendojnë të kundërtën.



## Meta dhe Rama përplasen për ministrin e emëruar, Gent Cakaj

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka refuzuar të enjten emërimin e Gent Cakajt në postin e ministrit të Jashtëm, i propozuar nga kryeministri Edi Rama, në kuadër të ristrukturimit të Qeverisë. Meta ka thënë se Cakaj ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative dhe shtetërore. Ndërkaq kryeministri Rama ka theksuar se vendimi i presidentit është "jo vetëm antikushtetues, por edhe i turpshëm"

**TIRANË, 10 JANAR** - Njëpër një një letre drejtuar kryeministrit Edi Rama, presidenti Ilir Meta shprehet se "profili i zotit Genti Cakaj, i propozuar për postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative, shtetërore, në secilin element dhe në tërësi". Cakaj, i cili është me prejardhje nga Kosova, ka qenë për një periudhë këshilltar i kryeministrit dhe prej shtatë muajsh zëvendësministër i Jashtëm, i ngarkuar për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë.

Presidenti u ndal në dy argumente konkrete që, sipas tij, e bëjnë të papranueshme kandidaturën e Cakajt për postin e ministrit të Jashtëm, certifikata e sigurisë që është detyrim ligjor dhe qëndrimet publike të Cakajt sa i përket idesë së ndryshimit të kufijve në mes të

Kosovës dhe Serbisë.

Presidenti Meta tha se që nga momenti i emërimit të tij në postin e zëvendësministrit të Jashtëm, Gent Cakaj "i lind detyrimi ligjor që të aplikojë dhe të pajiset me certifikatat përkatëse të sigurisë", por ai e ka shmangur këtë detyrim.

Presidenti Meta, po ashtu, vlerëson se Cakaj "ka mungesë përvojë në politikë dhe se qëndrimet e tij janë të papranueshme". "Gent Cakaj ka dëshmuar me të dhëna, me fakte e qëndrime se jo vetëm që i mungon përvoja e sprovuar në fushën e politikës së jashtme, porse qëndrimet e tij publike lidhur me çështje thelbësore të politikës rajonale janë të papranueshme", u shpreh Meta duke iu referuar disa deklaratave të Gent Cakajt lidhur me idetë për ndryshim të kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë gjatë një emisioni televiziv.



Presidenti theksoi se "këto deklarata të rrezikshme të zotit Gent Cakaj, me pasoja të paparashikueshme në rajon dhe më gjerë, në planin dypalësh dhe më tej, janë në kundërshtim të hapur me politikën rajonale të shtetit shqiptar, të NATO-s dhe të vetë Bashkimit Evropian".

Ndërsa vë në dukje rëndësinë dhe rolin e Ministrisë së Jashtme shqiptare përballë disa sfidave të afërta të diplomacisë si në kuadër të presidencës së ardhshme të OSBE-së ashtu edhe në pritje të vendimit për hapjen e bisedimeve për anëtarësim me BE-

në, presidenti Meta e mbyll letrën e tij dërguar kryeministrit duke u shprehur se "kandidatura e zotit Gent Cakaj nuk i plotëson kushtet, nuk ofron garancitë e nevojshme për ushtrimin me objektivitet dhe në lartësinë e kërkuar të detyrës tepër të rëndësishme të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme". Derisa ka refuzuar dekretimin e ministrit të ri, presidenti Meta nuk ka firmosur ende shkarkimin e ministrit aktual, Ditmir Bushati, i cili vijon të mbetet zyrtarisht në detyrë. Kryeministri Edi Rama përmes

një postimi në "Twitter" tha se vendimi i presidentit është "jo vetëm antikushtetues, por edhe i turpshëm". Presidenti Meta i është përgjigjur prapë kryeministrit në rrjete sociale, duke thënë se "pavarësia, integriteti territorial i Kosovës dhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë të padiskutueshme për Republikën e Shqipërisë". Kryeministri Rama në fund të muajit dhjetor largoi më shumë se gjysmën e anëtarëve të kabinetit të vet që mbanin poste si ministra në pesë vjetët e qeverisjes nga Partia Socialiste.

## Basha: Banorët do ta hedhin të gjithë Qeverinë në Lanë

**TIRANË, 10 JANAR** - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ishte i pranishëm në protestën e banorëve të Astirit kundër projektit të "Unazës së re" që planifikon prishjen e disa banesave dhe bizneseve.

Basha tha se Rama nuk ia arriti të përçajë protestën, por se ishin qytetarët ata që dolën fitimtarë duke përçarë qeverinë, që çoi në zëvendësimin e ministrave. "Kur kërkon një drejtësi dhe qytetarët e

pafajshëm të mbrohen nga ligji, nuk rrezohet qytetari. Asgjë s'është më e fuqishme se kauza e drejtë. Vegla më tinëzore e Ramës, përçarja e qytetarëve, nuk piu ujë. Por këta banorë në të drejtën e tyre përçarë qeverinë. Një media e rëndësishme amerikane publikoi dje faktin që ne e kemi përsëritur. Të gjithë e dinë sesi nisi kjo aferë. U turrën pa marrë leje për t'i prishur shtëpitë, pa çarë kokën për banorët. Banorëve i

vërsulën Policinë e Shtetit dhe atë Bashkiake, nga Rama te Veliaj e Gjyknuri hidhnin vallen e hienave duke shantazhuar banorët. Qëndresa e banorëve, bashkë me opozitën dhe disa gazetarë, nxorën aferën korruptive të një kompanie fantazmë, të një plani për të zhvendosur Lanën dhe për të shkatërruar shtëpitë e banorëve që të mos prekej rezidenca e një trafikanti droge", tha Basha.





Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, është pritur në takim nga ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas

# Maasi: Duhet ta mbajmë premtimin për liberalizimin e vizave për Kosovën

Gjermania do ta përkrahë liberalizimin e vizave për Kosovën, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si dhe përfundimin e dialogut me Serbinë. Kështu ka deklaruar të enjten në Berlin ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, gjatë takimi me zëvendëskryeminstriin e parë dhe ministriin e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli. Po ashtu, ministri Maas ka ofruar mbështetje edhe për përshtetimin e procedurave për njohjen e patentëshoferëve


**EPOKA  
ERE**

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Zëvendëskryeminstri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, të enjten është pritur në takim nga ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, me të cilin ka biseduar për proceset nëpër të cilat po kalon shteti i Kosovës. Me këtë rast ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, ka bërë me dije se shteti gjerman është pro liberalizimit të vizave për Kosovën. Maas ka thënë se Kosova ka përbushur të gjitha kriteret dhe është zotuar se do të punojë për t'iu mundësuar qytetarëve të Kosovës lëvizjen pa viza në Evropë. "Për çështjen e lëvizjes pa viza ka pasur disa kushte për t'u plotësuar në mënyrë të veçantë. Është bërë fjalë për 95 kriteret të cilat janë plotësuar të gjitha nga Kosova. Ne duhet t'i mbajmë premtimet tona. Shikojmë që proceset reformative brenda Kosovës janë duke u zhvilluar në mënyrë konsekuente. Prandaj brenda Qeverisë si dhe rrethit të anëtarëve të Bashkimit Evropian unë do të angazhohem që të realizohet edhe ky qëllim, lëvizja e lirë e

qytetarëve të Kosovës në Evropë", është shprehur Maas në një konferencë të përbashkët për medie me homologun e tij Behgjet Pacolli.


Shefi i diplomacisë gjermane ka premtuar përkrahje për Kosovën edhe sa i përket procesit të integritimit evropian, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si dhe për procesin e dialogut me Serbinë i cili, sipas tij, duhet të sjellë njohje reciproke si dhe anëtarësim të Kosovës në OKB. Po ashtu, ministri Maas ka ofruar mbështetje edhe për përshtetimin e procedurave për njohjen e patentëshoferëve. Ndërsa zëvendëskryeminstri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, ka falënderuar Gjermaninë për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës dhe qytetarëve të saj. "Patëm diskutim shumë konstruktiv dhe besoj se ky takim do t'iu shërbejë marrëdhënieve tona të shkëlqyera me palën gjermane. Gjermania është partnerja kryesore e Kosovës. Kosova dhe qytetarët e saj janë mirënjohës dhe falënderues ndaj shtetit të Gjermanisë që ka kontribuar për formimin e shtetit dhe demokracisë së ven-



dit", ka deklaruar Pacolli, duke shtuar se Kosova ka nevojë për mbështetjen e mëtutjeshme të Gjermanisë në procesin e integritimit evropian. Ministri Pacolli ka thënë se Gjermania duhet të jetë edhe më e pranishme në Kosovë përmes ekonomisë dhe investitorëve të saj. "Gjermania ka kontribuar dhe vazhdon të komunikojë ekonomisht si partneri i dytë tregtar për Kosovën, por jo edhe vetëm si tregtar, por edhe si investues. Jo shumë kohë ka kaluar kur në kampin ku ushtria juaj ishte në Prizren, ia dedikuat mirëqenies qytetare duke e kthyer në një qendër inkurajuese. Emri i Gjermanisë duhet të identifikohet

po ashtu me Prizrenin. Ne si partnerë e meritojmë praninë e GIZ-it në Kosovë. Kosova tani është edhe më e përgatitur dhe më atraktive për ardhjen e investitorëve", ka theksuar Pacolli. Zëvendëskryeminstri Pacolli në takimin me homologun gjerman ka folur edhe për dialogun me Serbinë dhe taksën ndaj produkteve serbe. Pacolli ka thënë se ekipi negociator do të jetë në mbështetje të plotë të presidentit Hashim Thaçit për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. "Kuvendi i Kosovës ka caktuar një grup dialogues që do të jetë në mbështetje të plotë të presidentit Thaçi i cili do ta udhëhe-

që dialogun me Serbinë, që besoj se do të kryhet këtë vit ku do të kemi paqe me Serbinë. Kjo e mundëson integritimin e mëtejshëm të Kosovës dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Serbia në bazë të kësaj marrëveshjeje duhet ta njohë përgjithmonë Kosovën", ka deklaruar Pacolli. Sipas Pacollit, vendosja e taksës ndaj mallrave të Serbisë nuk është vendim ndëshkues, por është sqarim për Serbinë se Kosova është shtet i pavarur dhe nuk negociocion me askënd për statusin e saj. Zëvendëskryeminstri Pacolli ka thënë se Kosova pret përbushjen e premtimit për liberalizimin e vizave nga disa vende të caktuara.





Flet për "Epokën e re", Hysni Gucati

# Të bashkëpunojmë me drejtësinë

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, ka ftuar veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që të bashkëpunojnë me drejtësinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Gjykata Speciale është raciste, por për të mirën e shtetit duhet të bashkëpunohet me këtë institucion. Megjithatë, Gucati nuk e ka përjashtuar mundësinë e organizimit të protestave për ta kundërshtuar këtë gjykatë. "Por, për momentin, rruga dhe protesta nuk na konvenojnë. Mirëpo çdokush duhet ta dijë se edhe durimi i veteranëve të UÇK-së e ka një fund", ka thënë Gucati. Ai ka treguar se OVLUÇK-ja është e informuar nga Ministria e Drejtësisë për gjithë procesin

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, i ka ftuar të gjithë veteranët e UÇK-së që të bashkëpunojnë me drejtësinë. Ai ka thënë se këtë duhet të bëjnë për hir të shtetit të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai e ka kundërshtuar Gjykatën Speciale, duke thënë se kjo gjykatë është e padrejtë dhe raciste. "Ne i ftojme të gjithë veteranët të bashkëpunojnë me drejtësinë. Ne këtë ftesë e bëjmë sepse bashkëpunimi me drejtësinë është për të mirën e vendit tonë, mirëpo edhe drejtësia nuk duhet të na keqpërdorë neve. Deri më tani drejtësia na ka keqpërdorur duke ngritur aktakuzat të pabaza dhe pa fakte", ka thënë Gucati. Ai ka thënë se janë kundër një drejtësie selektive, por jo kundër drejtësisë. "Ne si OVLUÇK kemi kërkuar vazhdimisht të krijohet Gjykata Speciale vendore e cila do t'i ndiqte të gjitha krimet që janë shkaktuar në Kosovë. Përsëri

po e them se nuk jemi kundër drejtësisë, por konsiderojmë se nuk po ndiqen krimet. OVLUÇK-ja do ta përcjellë me vëmendje situatën dhe reagimet do t'i bëjë në përputhje me zhvillimet", ka thënë ai. Gucati nuk e ka përjashtuar mundësinë e organizimit të protestave për ta kundërshtuar këtë gjykatë. Por, sipas tij, tani për tani nuk e shohin të arsyeshme të dalin në rrugë dhe të organizojnë protesta. "Ne nuk do të protestojmë pse nuk duam të përballemi me drejtësinë, por ne do të dalim për t'i treguar opinionit të Kosovës dhe atij botëror se UÇK-ja nuk ka bërë krime ndaj askujt", është shprehur Gucati.

**"Epoka e re":** Z. Gucati, Kryesia e OVLUÇK-së të mërkurën ka mbajtur mbledhje të kryesisë. Çka është diskutuar në këtë mbledhje?

**Gucati:** Kemi diskutuar edhe rreth situatës aktuale në vend dhe rreth ftesave të fundit që i ka bërë Gjykata Speciale për ish-pjesëtarët e UÇK-së. Kryesia e OVLUÇK-së ka ritheksuar edhe një herë se Gjykata Speciale është



një e padrejtë që i ka ardhur Kosovës sepse është e njëanshme dhe nuk i gjykon krimet e shkaktuara nga Serbia pushtuese, pasi shumë vjet që nga paslufta ishimi dëshmitarë të dështimit

total të drejtësisë ndërkombëtare e cila nëpërmjet mekanizmave të ashtuquajtur të drejtësisë vazhdimisht organizoi komplete kundër luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**"Epoka e re":** Mund të pritet ndonjë veprim i veteranëve si shenjë pakënaqësie ndaj kësaj gjykate?


**Gucati:** Nuk e përjashtojmë

## Haradinaj informohet nga Limaj e Ahmeti për takimin në Bruksel

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim bashkëkryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, nga të cilët është informuar për takimin me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian (BE), Federica Mogherini. "Takim informues nga

bashkëkryesuesit e delegacionit shtetëror për bisedimet me Serbinë, Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, për rrjedhën e vizitës në Bruksel. Delegacionin shtetëror e përgëzova për paraqitjen e shkëlqyer të qëndrimeve të Kosovës përballë zyrtarëve të BE-së për dialogun me Serbinë. Arritja e marrëveshjes gjithëpërfshirëse

me shtetin fqinj, që do të thotë njohje reciproke ndërmjet dy shteteve, i siguron Kosovës ulësen në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Kosova, e përkushtuar për paqe të qëndrueshme dhe stabilitet, është e vendosur për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë", ka thënë Haradinaj pas takimit.





# Drejtësinë për hir të shtetit



mundësinë e protestave për ta kundërshtuar këtë proces, mirëpo për momentin ne nuk do të dalim në rrugë. Nëse i shohim të nevojshme protestat, do t'i organizojmë.

**"Epoka e re":** Çfarë do t'ju shtynte të dilnit në protesta?

**Gucati:** Shpifjet që janë bërë dhe po bëhen ndaj ish-pjesëtarëve dhe ish-komandantëve të UÇK-së. Ne nuk do të

protestojmë pse nuk duam të përballemi me drejtësinë, por do të dalim për t'i treguar opinionit të Kosovës dhe atij botëror se UÇK ja nuk ka bërë krime ndaj askujt.

**"Epoka e re":** Si e keni pritur ftesat e para për intervistim të ish-pjesëtarëve dhe komandantëve të UÇK-së nga Specialja?

**Gucati:** Natyrisht se ne i kemi pritur shumë keq këto ftesa për intervistim. Kemi qenë të vetëdijshëm se këto ftesa do të vijnë pas funksionalizimit të kësaj gjykate, mirëpo nuk i kemi pritur mirë. Ne vazhdimisht jemi përballur deri më tani me drejtësinë vendore dhe ndërkombëtare. Si OVLUÇK kemi kërkuar vazhdimisht të krijohet Gjykata Speciale vendore e cila do t'i ndiqte të gjitha krimet që janë shkaktuar në Kosovë sepse përsëri e themi se nuk jemi kundër drejtësisë, por konsiderojmë se nuk po ndiqen krimet. OVLUÇK-ja do ta përcjellë me vëmendje situatën dhe reagimet do t'i bëjë në përputhje me zhvillimet.

**"Epoka e re":** Si OVLUÇK a jeni të informuar në mënyrë zyrtare nga ndonjë institucion me procesin e Gjykatës Speciale apo jeni të informuar vetëm prej medieve?

**Gucati:** Ne kemi pasur një takim me ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili na ka informuar se çka është duke ndodhur dhe si është duke shkuar ky proces. Ai na ka thënë se çdo veteran është mirë t'i përgjigjet drejtësisë. Pra, zyrtarisht jemi të informuar me procesin prej institucioneve të Kosovës dhe do të jemi në kontakt edhe në të ardhmen, ku do të informoheni për çdo gjë që ka të bëjë me këtë proces. Po e përsëris prapë, se si veteranë rrugën nuk e pëlqejmë, sepse nuk duam ta shkatërrojmë vendin tonë, por kjo çfarë është duke ndodhur me ne është e tepërt. Deri më tani UÇK-ja është përballur me katër lloje të gjykatave. Ky është turp. Kjo gjykatë për ne është raciste.

**"Epoka e re":** Si OVLUÇK keni kontakte me veteranët e Kosovës në terren? Cili është

reagimi i tyre?

**Gucati:** Ne ka një muaj që kemi kontakte të vazhdueshme me veteranët e UÇK-së nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Natyrisht as ata nuk i presin mirë këto ftesa dhe e kundërshtojnë një gjykatë të tillë, duke e vlerësuar të padrejtë. Edhe ata pyesin se pse ko gjykatë duhet ta gjykojë vetëm UÇK-në dhe jo forcat serbe të cilat kanë kryer krime në Kosovë. Normalisht se ata ndihen shumë të fyer nga ky proces. Ata presin çdo vendim tonin. Nëse ne ju themi të dalin në rrugë për të protestuar, ata do të dalin. Por, për momentin, rruga dhe protesta nuk na konvenojnë. Mirëpo çdokush duhet ta dijë se edhe durimi i veteranëve të UÇK-së e ka një fund.

**"Epoka e re":** Pra, u bëni thirrje veteranëve të bashkëpunojnë me këtë gjykatë dhe, në rast se ftohen, t'i përgjigjen pozitivisht asaj?

**Gucati:** Më vjen keq prej atyre që kanë shpifur për luftën e UÇK-së e që janë shqipfolës, por që janë dorë e zgatur e Serbisë. Atyre duhet t'u vijë turp për ato shpifje që i kanë bërë ndaj një ushtrie çlirimtare. Ne i ftojmë të gjithë veteranët të bashkëpunojnë me drejtësinë. Ne këtë ftesë e bëjmë sepse bashkëpunimi me drejtësinë është për të mirën e vendit tonë. Edhe drejtësia nuk duhet të na keqpërdorë neve. Deri më tani drejtësia na ka keqpërdorur duke ngritur akuza të pabaza dhe pa fakte. Provat mbi të cilat bëhen këto akuza janë të fabrikuar nga Serbia dhe disa shqipfolës në Kosovë të cilët jetojnë dhe veprojnë ende.

**"Epoka e re":** Cilat janë pritjet e juaja nga kjo gjykatë?

**Gucati:** Jam i bindur se UÇK-ja do të dalë e pastër nga kjo gjykatë sikurse ka dalë edhe në proceset e mëhershme gjyqësore. Ne kemi bërë luftë çlirimtare dhe të drejtë.

## Ambasadori amerikan konfirmon përkrahjen për Gjykatën Kushtetuese

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Arta Rama-Hajrizi, ka pritur të enjten në takim njohës ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, të cilin fillimisht e ka uruar për detyrën e re. Më tutje, Rama-Hajrizi e ka njoftuar ambasadorin Kosnett me punën e deritanishme të Gjykatës

Kushtetuese të Kosovës si dhe me sfidat me të cilat është përballur ky institucion gjatë vitit që shkoi, veçanërisht në aspektin e funksionimit dhe të vendimmarrjes. Ajo ka thënë se largimi i njëkohshëm i katër gjyqtarëve të generatës së parë të emëruar në Gjykatën Kushtetuese dhe humbja e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje vitin e kaluar ishin ndër sfidat kryesore të kësaj

gjykate. Rama-Hajrizi ka thënë se nga themelimi në vitin 2009, Gjykata Kushtetuese tek tani në përbërjen e saj ka vetëm gjyqtarë vendorë, me ç'rast ka shprehur falënderimin për kontributin dhe për punën e çmuar të gjyqtarëve të larguar ndërkombëtarë. Gjatë këtij takimi, ajo ka diskutuar me ambasadorin amerikan edhe për zhvillimet e fundit në gjyqësinë kushtetuese të



Kosovës, për mundësitë e konsolidimit të mëtejshëm të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe për reformat e nevojshme legjislative në funksion të forcimit të sundimit ligjit. Ndërsa ambasadori amerikan

Philip Kosnett, pasi ka konfirmuar përkrahjen e tij për pavarësinë në punën e Gjykatës Kushtetuese ka shprehur zotimin për thellimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike në të gjitha fushat me interes reciprok.



## Institucionet arsimore të Kosovës në grevë nga 14 janari



PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka marrë vendim që më 14 janar të hyjë në grevë të përgjithshme në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës, në shenjë pakënaqësie me nivelin e pagave. "Greva fillon çdo ditë nga ora 9:00 deri në orën 12:00 për të gjithë

grevistët e të gjitha ndërrimeve. Pas përfundimit të orarit të grevës, të punësuarit e lëshojnë objektin, në të cilin është zhvilluar greva, për të vepruar kështu çdo ditë të grevës. Gjatë periudhës sa zgjat greva e përgjithshme, ndërpriten të gjitha aktivitetet që lidhen me punën në institucionet arsimore", është thënë në njoftimin e

SBASHK-ut. Sipas SBASHK-ut, vendimi është marrë duke u bazuar në Ligjin e grevës dhe në statutin e kësaj sindikate. Ndërkaq ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije se janë duke punuar për ta gjetur zgjidhjen e duhur për ta parandaluar grevën e SBASHK-ut të paralajmëruar më 14 janar.

## Situata epidemiologjike e fruthit në Kosovë nën kontroll

**EPOKA  
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 JANAR - Kosova radhitet në mesin e vendeve me përqindje të lartë të vaksinimit. Sipas statistikave zyrtare, rreth 95 për qind e fëmijëve janë vaksinuar, sukses ky që ka parandaluar epidemitë për 10 sëmundje me vaksinë preventabile. Kështu është thënë në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK). "Fruthi është një nga sëmundjet që, falë vaksinimit, nuk kishte shënuar epidemi në Kosovë. Megjithatë, këtë vit janë shënuar 94 raste të fruthit të diagnostikuara në laboratorët e Institutit Kombëtar. Pjesa dërmuese e rasteve të fruthit janë regjistruar në komunitetin RAE dhe fëmijët e riadhesuar që të gjithë të pavaksinuar. Sipas

Programit të Zgjeruar të Vaksinimit, vaksinimi kundër fruthit me vaksinën MMR është i obliguar me Ligj dhe i nënshtrohen të gjithë fëmijët e moshës 12 muajsh dhe gjashtëvjeçare me 1 dozë prej 0.5ml", është thënë në njoftimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës. Sipas këtij njoftimi, nëse fëmija nuk është vaksinuar në periudhën kohore të caktuar, prindi është i obliguar ta kompletojë statusin vaksinal të fëmijës sa më parë. "Përrjashtim bëjnë vetëm fëmijët që për çfarëdo arsye qoftë kanë kundërrindikacion specifik për vaksinim. Sëmundja e fruthit karakterizohet me shkallë të lartë të infektueshmërisë andaj edhe përhapja brenda territorit të caktuar është e shpejtë. Rreziku ndërshtetëror i importimit të sëmundjes nga vendet fqinje dhe vendet e Evropës është perma-



nent pasi që sëmundja përhapet me ajër", është bërë me dije në këtë njoftim. IKShPK-ja ka vlerësuar se në vitet e fundit, sipas Organizatës

Botërore të Shëndetësisë, fruthi ka "rilindur" në Evropë, ku numri i njerëzve të infektuar që nga viti 2007 është trefishuar shkaku se nuk janë vaksinuar me rregull.

Thuhet se në shumë vende të Evropës janë regjistruar të sëmurë dhe të vdekur nga fruthi. Organizata Botërore e Shëndetësisë raporton për rritje të shkallës së sëmundshmërisë nga fruthi në rajonin e Evropës dhe Ballkanit, përfshirë edhe Maqedoninë, e cila javën e kaluar ka shpallur epidemi. "Në Kosovë situata epidemiologjike me fruth është në kontroll të plotë dhe në mbikëqyrje permanente nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. Duke qenë se jemi në stinën e ftohtë të dimrit, kur qytetarët mblidhen në dhoma të ngrohta, të paajrosura, mundësia e përhapjes së fruthit rritet, por gjithnjë vetëm te fëmijët e pavaksinuar. Aktualisht në laboratorët e Institutit Kombëtar nuk ka asnjë rast të izoluar të fruthit", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

## Studentët protestojnë, kërkojnë liberalizimin e vizave



PRISHTINË, 10 JANAR - Studentët e Universitetit të Prishtinës përmes një proteste të enjten ua kanë përsëritur kërkesën shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që t'i liberalizojnë vizat për qytetarët

e Kosovës. Përfaqësuesit e studentëve në këtë marsh protestues thanë se nuk e duan lirinë e lëvizjes për të ikur nga Kosova e as punuar punë të rënda, por për ta treguar talentin e tyre, studiuar e

fituar përvoja me të cilat do t'i ndihmonin zhvillimit të vendit të tyre. Për dallim nga 24 dhjetori, kur studentët marshuan nga kompleksi universitar deri te Zyra e

Bashkimit Evropian në Prishtinë, këtë herë u ndalën te hapësira në mes të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, duke fajësuar edhe përfaqësuesit politikë në këto dy institucione. Në fund ata bënë një

rreth me flamuj të vendeve që lëvizin lirshëm në Zonën Shengen, duke mbajtur në dorë edhe një baner me mbishkrimin "A është izolimi vlerë e Bashkimit Evropian?"



# Haradinaj kërkon mobilizim për një Kosovë të pastër

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të enjten në konferencën përmbyllëse të fushatës "Ta Pastrojmë Kosovën", të iniciuar nga Zyra e Kryeministrit. Kjo konferencë ka bërë bashkë një numër të madh institucionesh dhe organizatash nga vendi dhe të huaja, një task forcë nacionale, që për tre muaj kishte për qëllim aksionin e çuditshëm të pastrimit të Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se në ditët e kaluara me aktivistët janë takuar te deponitë ilegale, derisa sot po e përmbyllin një aksion që për herë të parë ka ndodhur në Kosovë.

Haradinaj në fjalën e tij ka shfaqur popullin e Kosovës për këta 20 vjet që janë hedhur mbeturina sepse, sipas tij, ka pasur emergjenca dhe probleme, si dhe rrethana shumë të

rënda, mungesë të institucioneve dhe se kuptohet pse ka ardhur deri te kjo gjendje. "Mirëpo, tani nuk mund të pajtohem që edhe në vitet që vijnë të ndodhë po e njëjta gjë dhe të hedhet mbeturinë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se është e palejueshme të mbushen prapë deponitë ilegale.

Haradinaj ka thënë se angazhimi i tyre disamujor ka dhënë rezultat dhe se sot është një Kosovë më e pastër. Në këtë kontekst, ai ka falënderuar komnatat që kanë dhënë një kontribut, por edhe angazhimin shembullor të mijëra aktivistëve për një Kosovë më të pastër. "Do të organizohemi së bashku, me institucionet e vendit, me organizatën 'Let's do it', por duhet të gjejmë edhe një zgjidhje për riciklim të mbeturinave", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se, krahas vetëdijesimit dhe mobilizimit qytetar dhe institucional që është i nevojshëm dhe kra-

has politikave ndëshkuese dhe shpërblyese, të mendohet edhe për opsionin real, riciklimin e mbeturinave. "Duhet të jemi të mobilizuar për një Kosovë të pastër", ka thënë Haradinaj. Ndërsa ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë se nuk do të lejojnë që asnjë person i papërgjegjshëm të marrë të drejtën dhe ta dëmtojë ambientin që u takon të gjithëve.

Në anën tjetër, koordinatori i iniciativës "Ta Pastrojmë Kosovën", Luan Hasanaj, ka thënë se për këtë nismë janë angazhuar të gjithë duke dhënë kontribut që Kosova të bëhet një vend më i mirë për të jetuar dhe një vend më aktiv në një shoqëri e cila angazhohet vetë që vendin ta bëjë më të mirë. "Nga sot e tutje ne vazhdojmë aktivitetet e tjera që ta pastrojmë mjedisin. Nuk përmbyllet sot, siç nuk është përmbyllur as më 15 dhjetor kjo fushatë. Së bashku me kryeministrin jemi pajtuar që në këtë vit do të

angazhohen 1 000 kujdestarë mjedisi të cilët do ta ndihmojnë edhe komunën edhe ndërmarrjen dhe të gjithë neve për një vend më të pastër", ka thënë Hasanaj. Kurse kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Agim Veliu, ka thënë se në shumë raste ky asociacion ka kërkuar që procesi i riciklimin të mbeturinave të nisë menjëherë si një nevojë imediate për Kosovën.

Task Forca për Pastrimin e Kosovës për tre muaj aktivitet

ka arritur të themelojë 32 task forca komunale, të pastrojë 952 deponi ilegale, duke i angazhuar rreth 200 mijë vullnetarë në gjithë vendin. Po ashtu, kjo taskë forcë ka krijuar 11 zona të gjelbëruara derisa shumë të tjera janë në proces. Po me këtë nismë në vitin që kemi hyrë do të pastrohen edhe lumenjtë e Kosovës, do të shikohet mundësia që të angazhohen kujdestarë të mjedisit dhe mbledhja e fidanëve në gjithë vendin.

## MMPH-ja ndan grantin prej 1.2 milion eurosh për dhjetë komuna të Kosovës

Pas përfundimit të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën", dhjetë komuna të Kosovës që janë treguar më efikase për eliminimin e mbeturinave kanë fituar grant nga

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vlerë prej 1.2 milionë eurosh, grant ky që do të përdoret në projekte për mbrojtjen e ambientit për këto komuna.



## Kurti takohet me ambasadorin francez, thotë se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, dhe sekretari për marrëdhënie me jashtë i kësaj partie, Boiken Abazi, kanë pritur të enjten në selinë e LV-së ambasadorin e Francës, Didier Chabert, dhe zëvendësambasadorin Carole Blestel-Feffer. Sipas njoftimit të LV-së, ambasadori tregoi interesimin për të folur për tema të shumta që kanë lidhje me situatën politike dhe ekonomike në Kosovë,

duke shprehur edhe një herë mbështetjen e Francës për shtetin e Kosovës. Kurti në këtë takim ka theksuar nevojat e mëdha ekonomike dhe sociale që kanë shtresa të ndryshme të popullit në Kosovë, nga punësimi e deri tek investimet dhe se si ka dështuar modeli ekonomik në linjën e të cilit po ecën qeveria aktuale. Ai ka theksuar edhe një herë domosdoshmërinë për t'u mos u ngutur e për të mos bërë gabime në dialogun me Serbinë.

"Duhet t'ia nisim nga vlerësimi në Kuvend i marrëveshjeve të arritura deri më sot. Ky vlerësim po ndalet me qëllim nga kryetari i Kuvendit. Më tej, kryetari Kurti shpjegoi për mungesën e legjitimitetit demokratik të ekipit negociator dhe të qeverisë, si dhe për nevojën për të mbajtur zgjedhje të parakohshme nga të cilat do të dilnin institucione legjitime dhe demokratike", është bërë me dije në njoftimin e LV-së.



## Komuna e Mitrovicës fiton grant në vlerë prej 93 681 eurosh

MITROVICË, 10 JANAR (ER) - Komuna e Mitrovicës është kualifikuar në mesin e 19 (nëntëmbëdhjetë) komunave më të suksesshme të Republikës së



Kosovës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, së bashku me SDC/DEMOS, ka përmbyllur procesin e vlerësimit për Grantin e Performancës për vitin 2019, prandaj Komuna e Mitrovicës është kualifikuar për grant dhe ka fituar shumë prej 76 525 eurosh. Ndërsa Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Zhvillimor Ndërkombëtar - SIDA bashkëfinancon Grantin e Performancës për vitin 2019 për Komunën e Mitrovicës në vlerë prej 17 156 euro. Shuma e fituar e Komunës së

Mitrovicës për Grantin e Performancës të vitit 2019 është në vlerë prej 93 681 eurosh. Këto mjete do të përdoren për projekte kapitale sipas prioriteteve të përcaktuara dhe nevojave emergjente të Komunës së Mitrovicës. Me këtë rast, Komuna e Mitrovicës ka shprehur falënderime ndaj MAPL-së, SDC/DEMOS dhe SIDA për vlerësimin gjatë procesit për Grantin e Performancës, duke u zotuar për përzgjedhjen e projekteve të qëlluara dhe të nevojshme për Komunën e Mitrovicës.



## Sigurohet strehim për familjen Cerroviku

MITROVICË, 10 JANAR (ER) - Në këtë stinë të ftohtë dimri Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Mirëqenies Sociale në Mitrovicë i ka dalë në ndihmë të enjten familjes Cerroviku, duke ia siguruar strehimin e përkohshëm, deri

në një zgjidhje të përhershme. Drejtoresha e Integritimit Evropian dhe Mirëqenies Sociale në Mitrovicë, Nazan Kërveshi, ka bërë me dije se në qytetin e Mitrovicës është një numër i madh i familjeve që jetojnë me gjendje të rëndë

sociale. Ajo ka thënë se me gjithë buxhetin e kufizuar, drejtoria që ajo udhëheq ka gjetur mundësinë që familjes Cerroviku t'i bëjë një zgjidhje të përkohshme duke iu siguruar strehimin e nevojshëm për këtë sezon dimëror.

## Bëhen ndryshime të reja në ekzekutivin komunal të Deçanit



DEÇAN, 10 JANAR (ER) - Muaji janar ka sjell ndryshime në ekzekutivin komunal të Komunës së Deçanit. Në një takim të përbashkët me drejtorë të drejtorive komunale, kryetari i komunës, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se që nga data 9 janar në ekzekutivin komunal ka ndryshime sa iu përket udhëheqësve të drejtorive komunale.

Musa Berisha është emëruar drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Më parë këtë dikaster e ka udhëhequr Ibrahim Selmonaj. Bekim Vishaj është emëruar drejtor i Drejtorisë për Arsim, ku deri më tani këtë dikaster e ka udhëhequr Qazim Maloku. Leonora Ukëhajdaraj është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte, ku deri më tani ky

dikaster është udhëhequr nga Faik Doda, i cili tashmë është emëruar këshilltar për kulturë, rini dhe sport. Dikasteret e tjera vazhdojnë të udhëhiqen nga drejtorët të cilët kanë qenë të emëruar deri më tani. "Drejtoria për Zhvillim Ekonomik udhëhiqet nga Fitore Shala, Drejtoria për Administratë Komunale nga Jashar Dobra, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural nga Nasim Haradinaj, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë nga Agron Muslijaj, Drejtoria për Inspeksion nga Halil Tolaj, Drejtoria për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim nga Izet Zenuni, Drejtoria për Bungjet dhe Financa nga Agron Demukaj dhe Drejtoria për Urbanizëm nga Ramë Melaj", është thënë në njoftimin për media të Komunës së Deçanit.

## Rrugët në Ferizaj janë të kalueshme

FERIZAJ, 10 JANAR (ER) - Pavarësisht prej reshjeve të vazhdueshme të borës, të gjitha rrugët në Komunën e Ferizajt janë të kalueshme, por në disa vende mund të ketë edhe vështirësi. Nga afër pastrimit e borës e kanë inspektuar edhe zyrtarë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

Ismajl Mehmeti, zyrtar i kësaj drejtorie, është shprehur se

mirëmbajtja e rrugëve gjatë këtij viti është në nivelin e kënaqshëm. "Raportimet nga terreni paraqesin gjendje të kalueshme në të gjitha rrugët lokale dhe ato që lidhin fshatrat me qytetin, ndërkohë një gjendje më e rënduar evidentohet në zonën malore të Jezercit dhe Burtnikut, ku niveli i lartë i reshjeve të borës ka bërë të vështirë ndërhyrjen e ekipeve tona,

ndonëse është bërë edhe ky intervenim", është shprehur Mehmeti.

Është bërë me dije se Komuna e Ferizajt së bashku me operatorët ekonomikë janë në gatishmëri të plotë në mënyrë që të mos ketë ndonjë fatkeqësi eventuale.

Me këtë rast apelohet për kujdes të shtuar nga vozitësit si dhe shmangie të qarkullimit përreth zonave malore.





## Japonia e interesuar ta financojë projektin "Kosova e Re"

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluca, ka pritur të enjten në takim një delegacion japonez nga Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JBIC), e udhëhequr nga drejtori i divizionit për financim të projekteve energjetike, Ryuta Suzuki dhe ambasadori i Kosovës në Japoni, Leon Malazogu. Në këtë takim është diskutuar rreth zhvillimeve në sektorin e energjisë të cilin e

mbulon Ministria e Zhvillimit Ekonomik, me theks të veçantë projektin e termocentralit "Kosova e Re".

Lluca ka thënë se Qeveria e Kosovës vazhdon të përballet me probleme energjetike për shkak të vjetërsisë së kapaciteteve aktuale energjetike siç janë "Kosova A" dhe "Kosova B". Ai ka theksuar rëndësinë që projekti Termocentrali "Kosova e Re" ka për zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbi të gjitha për

qytetarët e Kosovës. Ai ka thënë se "Contour Global" planifikon ta vendosë gurtthemelin e termocentralit të ri gjatë gjysmës së parë të këtij viti dhe ta përfundojë deri në vitin 2023.

Ndërkaq Ryuta Suzuki ka deklaruar se Kosova ka rëndësi strategjike për vendin e tyre dhe se Japonia është e interesuar ta përkrahë financimin e projektit "Kosova e Re" për shkak se ky projekt ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.



# Kryeministri zotohet për reforma ekonomike

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 JANAR - "Do të punoj pa asnjë hezitim për temat e ekonomisë", ky ishte zotimi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi zhvilloi një takim pune në Odën Ekonomike Amerikane, bashkë me përfaqësues të bizneseve amerikane në vend dhe sipërmarrës të tjerë. Në këtë bashkëbisedim, të hapur edhe për mediet, kryeministri Haradinaj ka thënë se në Kosovë gjatë vitit të kaluar për fat të mirë disa punë rreth aspektit legjislativ janë realizuar dhe se infrastruktura e vendit, e ligjit dhe sigurisë, është përmblytur në tërësinë e vet. "E kemi përzgjedhur që ta vizitojmë sot Odën Ekonomike Amerikane si mekanizëm joqeveritar, por edhe për shkak të vlerës së gjithë juve dhe porosisë që e çoni si institucion, për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Amerikës. Angazhimi juaj është interes i shumanshëm i vendit tonë dhe unë ju përgëzoj për një vit të mbarë pune", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ai ka theksuar se do të punohet që të shkurtrohet koha e komunikimit të ndërsjellë mes palëve që të gjithë aktorët ekonomikë ta kenë mundësinë sa më shpejt të komunikojmë me aktorët të tjerë, por edhe Qeverinë. "Qëllimi i këtij mobilizimi është që të mos iu



vonohet ndonjë proces i komunikimit dhe ju bëj thirrje të jeni sa më të hapur në lidhje me tema të ndryshme që i përfaqësoni", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke ritheksuar edhe një herë se ky është një vit i ekonomisë dhe të gjithë mekanizmat institucionalë, ministritë, agjencitë, por edhe komunitat, do të jenë në funksion të ngritjes ekonomike. Po ashtu, Haradinaj ka thënë se janë në dijeni se taksa e vendosur ndaj shtetit serb i ka shkaktuar disa çrregullime dhe

vështirësi në të bërit biznes, por ka sqaruar se kjo taksë nuk është bërë kundër prodhuesve vendorë, por si rezultat i praktikave të caktuara dhe agresive nga Serbia dhe mohimi i të drejtave tona në të bërit biznes. Kryetari i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se në Odën Ekonomike Amerikane nuk ka më mirë se si të nisë viti sesa me një takim me kryeministrin Haradinaj, me të cilin ka thënë se diskutuan për shumë tema me rëndësi për zhvillimin ekonomik.

Presidenti i Bordit të OEA-së, Ilir Ibrahim, ka thënë se si Odë Ekonomike Amerikane janë të gatshëm dhe të hapur për dialog publik me institucionet qeveritare sepse, sipas tij, në OEA ka segmente të mjaftueshme të cilat do të mund të ishin në imputin e tyre për vizionin të cilin e ka Qeveria për zhvillimin ekonomik. Kryeministri Haradinaj në bashkëbisedim me sipërmarrësit dhe përfaqësuesit e bizneseve amerikane që operojnë në Kosovë

u është përgjigjur shumë pyetjeve që kanë të bëjnë me politikat ekonomike të Qeverisë dhe pengesave të tjera administrative dhe burokratike që u bëhen bizneseve në vend.

Me këtë rast kryeministri Haradinaj ka thënë se inkurajon Odën Ekonomike Amerikane, edhe mekanizmat e tjerë ekonomikë, që të bëhen partnerë të Qeverisë për identifikimin e të gjitha pengesave për zhvillim ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

## GLPS-ja: Rritja e numrit të këshilltarëve, abuzim me buxhetin e Kosovës

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka reaguar ndaj nxjerrjes së rregullores përmes së cilës Qeveria e Kosovës ka rritur skajshmërisht numrin e këshilltarëve politikë për kryeministrin dhe zëvendëskryeministrat. GLPS-ja ka vlerësuar se një vendim i tillë është abuzim me pushtetin. Sipas GLPS-së, rritja e numrit të këshilltarëve politikë për kryeministrin në 24 dhe për zëvendëskryeministrat deri në

11 përbën minim të reformës së administratës publike dhe abuzim të pastër të buxhetit të Kosovës. "Në skenarin aktual, me një qeveri që ka pesë zëvendëskryeministra, numri total i këshilltarëve të brendshëm të Zyrës së Kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave shkon në 65 këshilltarë politikë, asnjë arsye objektive nuk mund të arsyetojë një numër kaq të madh këshilltarësh politikë dhe kjo nuk mund të arsyetohet ndryshe pos me qëllimet klien-

teleske të Qeverisë Haradinaj, që njëherësh kontribuon edhe në rrënimin e imazhit të Kosovës pranë Komisionit Evropian", thuhet në reagimin e GLPS-së. GLPS-ja ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta anulojë Rregulloren 30/2018 përmes së cilës realizohet një rritje e tillë, ndërsa nga Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kërkuar të iniciojë zyrtarisht ndryshimin e Ligjit për buxhetin 2019 që do të parandalonte një rritje të tillë të numrit të këshilltarëve politikë.





# Rimilitarizimi i Ballkanit

Ballkani po rimilitarizohet pas demilitarizimit të filluar para çerek shekulli. Derisa asnjë nga shtetet anëtare dhe ato aspirante të NATO-s të rajonit nuk arritën 2 % të GDP-së të shpenzimeve ushtarake, Serbia shpenzon për ushtrinë më shumë se të gjitha shtetet e Ballkanit së bashku, apo shtatë herë më shumë se Shqipëria - shtet anëtar i Aleancës Veriatlantike. Baza ruse, blerja e armatimit rus, deri te paralajmërimi i dërgimit të ushtrisë ruse në Serbi, ndikuan që NATO të vendosë për ngritjen e bazës ajrore në Shqipëri, kurse Kosova ta krijojë ushtrinë e rregullt



Prof. dr. Blerim REKA

Trendi i shpenzimit të shtuar ushtarak u vërejt në të gjithë botën dhe ai po reflektohet edhe në Ballkan. Në vitin 2018 shpenzimet globale ushtarake u rritën në nivelin më të lartë që nga fundi i luftës së ftohtë: në 1.7 trilion dollarë. Në samitin e fundit të NATO-s, presidenti i ShBA-së, Donald Trump, këmbënguli se aleanca duhet ta dyfishojë objektivin e saj të shpenzimeve ushtarake (nga dy në katër për qind të bruto produktit vendor). BE-ja, ndërkaq, do të shpenzojë më shumë se pesë miliardë euro në vit për financimin e kërkimeve për mbrojtje dhe blerjen e armëve përmes fondit të saj të evropian të mbrojtjes.

Këto zhvillime ngritën shqetësime për një rimilitarizim edhe në rajon, qoftë nëpërmjet luftës hibride, apo vendosjes së bazave të reja ushtarake. Një çerek shekulli pasi vendet e Ballkanit filluan zvogëlimin e aftësitë e tyre ushtarake, shumë prej tyre filluan ta ndryshojnë kursin. Trendi i tillë u nxit sidomos nga vala mediatike e urrejtjes etnike dhe partive politike që shtyjnë agjendat nacionaliste.

Ky terren i përgatitur kështu do t'u ofrojë justifikim qeverive në rajon për t'i forcuar ushtritë e tyre dhe për t'i mbajtur institucionet e dobëta demokratike, duke u thirrur në mosmarrëveshjet e pazgjidhura ballkanike. Pos këtyre lojtarëve lokalë, tashmë në rajon filluan të përfshihen edhe fuqitë ushtarake globale. Serbia dhe Republika Srpska filluan t'i pranojnë armët ruse si dhe bazat e saj. NATO

planifikon të ndërtojë bazë ajrore në Shqipëri.

## NATO-ja përballë Rosisë

Aktualisht, shumica e aspirantëve të NATO-s nga Ballkani Perëndimor nuk përmbushin qëllimin e shpenzimeve të mbrojtjes prej 2 përqindësh të GDP-së. Maqedonia arriti atë objektiv në vitin 2007 (me 2.15 për qind të GDP-së së saj në mbrojtje), mirëpo këtë vit ra në 1 për qind të GDP-së si rezultat edhe i reduktimit të planifikuar në personelin ushtarak aktiv të vendit: nga afro 8 200 në 6 800 trupa.

Serbia mbetet shteti me buxhet më të madh ushtarak në rajon: në vitin 2017 shpenzoi 731 milionë dollarë (sipas Institutit Ndërkombëtar të Stokholmit për Kërkimin e Paqes-SIPRI). Shqipëria shpenzoi 162 milionë dollarë, Maqedonia 112 milionë dollarë dhe Mali i Zi 74 milionë dollarë. Buxheti i Kosovës për ushtrinë e saj në vitin e ardhshëm do të jetë 98 milionë euro.

Serbia, me rreth 30 mijë trupa, mbetet fuqia më e madhe ushtarake në Ballkanin Perëndimor, kurse Shqipëria e dyta. Kosova do t'i transformojë "Forcat e Sigurisë" të saj në një ushtri të rregullt këtë vit. Bosnjë e Hercegovina, e cila është shumë afër për t'u bërë shtet i dështuar, dëshiron të bëhet anëtar i NATO-s. Megjithatë, Republika Serpska me veton e saj në nivel federal do të blloktojë çdo iniciativë të tillë. Tri javë përpara zgjedhjeve të përgjithshme të vitit të kaluar Republikën Serpska e vizitoi ministri i Punëve të Jashtme i Rosisë, Sergei Lavrov, për ta mbështetur zgjedhjen e Dodikut në Presidencën Federale.

Serbët, pra jashtë Serbisë, po bllokajnë anëtarësimin e vendeve të tjera në NATO, ndërkaq që ushtria e Serbisë ende mbështetet te Rusia.

sekretarin amerikan të Mbrojtjes Jim Mattis, vizituan vitin e kaluar vendin për ta kundërshtuar këtë fushatë të Kremlinit, kurse Kongresi i ShBA-së vjet miratoi tetë milionë dollarë për ta ndihmuar Maqedoninë që ta luftojë propagandën ruse. Ka të ngjarë që lufta hibride dhe gara ushtarake do ta ndajnë rajonin në dy zona të sigurisë: një nën ombrellën ruse (Serbi dhe Republika Srpska) dhe e dyta - vendet me orientim euroatlantik (Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi).

## Ideja për shkëmbim terriroresh

Harta ushtarake e Ballkanit duket e thjeshtë: Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina nuk janë anëtare të NATO-s, por kufizohen me fqinjët që janë apo aspirojnë anëtarësimin në aleancën veriatlantike. Rusia është e

pranishme në rajon nëpërmjet Qendrës Humanitare Ruso-Serbe në Nish, e cila ende nuk e ka fituar statusin diplomatik, pavarësisht shtytjes së fortë nga Moska. Mirëpo, qeveritë perëndimore e kundërshtojnë këtë, sepse konsiderojnë se qendra është e përfshirë në aktivitete të inteligjencës. Kjo bazë ruse është afër kufijve të Serbisë me dy anëtarë të NATO-s: Bullgarinë dhe Rumaninë, si dhe dy aspirantët e NATO-s: Maqedoninë dhe Kosovën.

Kremlini paralajmëroi se planifikon të krijojë një "qendër rajonale për dhënien në shërbim të helikopterëve të saj ushtarakë", e së voni edhe për dërgimin e trupave të saj në Serbi.

Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) ka bazën e vet në Kosovë që nga viti 1999 dhe së shpejti aleanca do ta fillojë ndërtimin e një baze ajrore në Kuçovë të Shqipërisë.





Ky rimilitarizim do të krijojë tensione serioze në rajon, në kohën kur po hapet 'Kutia e Pandorës' kufitare. Një propozim për rregullimin e kufijve /shkëmbimin e territoreve midis Serbisë dhe Kosovës ka ndarë aktorët kryesorë në katër blloqe: Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar (kancelarja gjermane Angela Merkel dhe kryeministria britanike Theresa May kategorikisht kundërshtojnë këtë ide); Komisioni Evropian (shefja e diplomacisë evropiane Federica Mogherini dhe komisionari i Zgjerimit të BE-së, Johannes Hahn, janë implicitë për); Shtetet e Bashkuara po vëzhgojnë nga afër, por nuk kanë marrë asnjë vendim duke paralajmëruar se jo çfarëdo marrëveshje do të pranohet nga Uashingtoni); dhe Rusia, (sipas zëdhënëses së MPJ Maria Zaharova) që do të "pranojë çdo marrëveshje që është e mirë për Serbinë".

Çështjet ushtarake dhe kufitare janë shumë të ndërlydhura në Ballkan, pasi politikanët në rajon shpesh bëjnë thirrje për dërgimin e ushtarëve për t'i mbrojtur kufijtë. Liderët mbështetës të këtij propozimi janë me të kaluar ushtarake: Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ishte udhëheqës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa presidenti serb Aleksandar Vuçiq ishte ministër i Informacionit në kohën e ish-presidentit jugosllav Slobodan

Milloseviq, gjatë luftërave ballkanike në vitet '90. Gjatë vizitës së tij në Kosovë në muajin shtator, presidenti Vuçiq mbajti një fjalim në të cilin vlerësoi Slobodan Milloseviqin. Me ithtarët e Milloseviqit si Vuçiqi dhe Daçiçi në pushtet në Beograd, çdo çmilitarizim i ri i Ballkanit duket shumë larg.

### Tensionet në mes të shqiptarëve dhe serbëve

Paqja ballkanike do të varet nga mënyra se si dy kombet më të mëdha - shqiptarët dhe serbët (secili me 7-8 milionë banorë) do t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre. Për më tepër se një shekull Ballkani është në pritje të një paqe të qëndrueshme, përfundimtare mes këtyre dy kombeve.

Bisedimet sekrete midis udhëheqësve nuk kanë gjasa të arrijnë këtë qëllim. Lufta e Parë Botërore, e cila filloi në Ballkan, shpërtheu pikërisht si rezultat i aleancave sekrete. Çështja kryesore është nëse ndryshimi i kufijve do të çojë në paqe apo më shumë luftë? Ministrja kroate e Punëve të Jashtme, Marija Pejcinovic Buriç, ka shfaqur hapur dyshimin se precedenti i tillë do të vendoste një shkëmbim territorial edhe në pjesë të tjera të rajonit. Droja është nga një efekt domino, në Maqedoni dhe Bosnjë e Hercegovinë.

Vetëm një pajtim i vërtetë midis Kosovës dhe Serbisë - me njohjen reciproke të shteteve - mund ta ndalojë rimilitarizimin e rajonit. Kjo duket e pamundur në një afat të shkurtër, duke marrë parasysh qëndrimin e ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë, Ivica Daçiçi, se Serbia "kurrë nuk do ta njohë Kosovën si shtet i pavarur".

Pas lobimit të fuqishëm serb për bllokimin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol, Qeveria në Prishtinë vendosi taksën prej 100 përqindësh ndaj importeve për mallrat nga Serbia, kurse Shqipëria dhe Kosova nënshkruan një marrëveshje për bashkim doganor. Beogradi paralajmëroi se Shqipëria dhe Kosova po lëviznin drejt bashkimit. Ministri serb i Mbrojtjes, Aleksandar Vulin, tha se ushtria e vendit të tij ishte "e përgatitur" për ta pushtuar Kosovën për t'i mbrojtur serbët që jetojnë atje. Në dhjetor, Kuvendi i Kosovës votoi krijimin e ushtrisë së rregullt prej 5 000 trupash, kurse kryeministria serbe Ana Brnabić kërcënoi se vendi i saj mund të ndërhyjë ushtarakisht, e presidenti Vuçiq inspektoi trupat serbe në kufirin Serbi - Kosovë. Qeveria e Kosovës si përgjigje tha se ushtria e saj do të përdoret për të kontribuar në misionet ndërkombëtare (si ato në Afganistan dhe Irak) dhe jo për t'u përdorë kundër serbëve në territorin e vet ose kundër vetë Serbisë. ShBA-ja, ndërkohë, dërgoi një kontingjent armësh për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

### Fokusi strategjik

Ballkani mbase do të jetë një pikë jo pak e rëndësishme në strategjinë e sigurisë së ShBA-së. NATO, për ta kundërshtuar Rusinë, në samitin e fundit u përqendrua në ofrimin e sigurisë nga deti Baltik deri në Ballkan. Përveç bazës së re ajrore të NATO-s në Shqipëri, ka të ngjarë që ShBA-ja të ketë një bazë të përhershme pas KFOR-it si dhe t'i vendosë 3 000 trupat e saj aktuale në Poloni në mënyrë të përhershme, siç kërkohet edhe nga Varshava zyrtare.

Të gjitha këto lëvizje janë në pajtim me "Iniciativën e tri deteve" ("Three Seas Initiative") për të krijuar një zonë stabiliteti mes Detit Baltik, Detit të Zi dhe Detit Adriatik. Së bashku me vendosjen e saj në shtetet baltike dhe bazën e saj të re në Shqipëri, porti i Konstancës në Detin e Zi të Rumanisë do të jetë crucial për NATO-n. Shqipëria, ndërkaq, e vendosur në detin Adriatik dhe Jon, me qasje të drejtpërdrejtë në Mesdhe, po përfundon pjesën e saj të gazsjellësit TAP, si një zvogëlim i varësisë evropiane nga gazi rus. Për më tepër, Kroacia planifikon të ndërtojë një terminal për gazin natyral të lëngshëm (LNG) në Adriatik, për t'i konkurruar gjithashtu gazit rus. Është e qartë se iniciativa e

re e tre deteve do ta lidhë sigurinë politike me sigurinë energjetike.

Gjatë Luftës së Ftohtë Evropa Juglindore u balancua në aspektin strategjik përmes formulës 2 + 2 + 2: dy anëtarë të NATO-s (Turqia dhe Greqia), dy shtete të Paktit të Varshavës (Bullgaria dhe Rumania) dhe dy shtete që nuk i përkasin asnjë blloku ushtarak (Jugosllavia dhe Shqipëria). Sot, Bullgaria, Rumania, Mali i Zi dhe Shqipëria kanë hyrë në NATO. Rusia po kthehet në rajon nëpërmjet aleatëve të saj, Serbisë dhe Republikës Srpska. Maqedonia ka gjasa të bëhet anëtar i 30 i NATO-s këtë vit, ndërsa Kosova shpreson t'i bashkohet Aleancës. Fundja, në Kosovë ndodhet Bondsteel - baza kryesore e Ushtrisë së ShBA-së nën komandën e KFOR-it, më e madhja në Evropë.

### Baza ajrore e NATO-s

Për një kohë të gjatë baza e vetme ushtarake e huaj në Ballkan ishte baza e Marinës sovjetike në ishullin Sazan të Shqipërisë. Pastaj Shqipëria u largua nga Pakti i Varshavës dhe mbeti neutrale për katër dekada derisa u bë anëtare e plotë e NATO-s në vitin 2009. Gjysmë shekulli pas bazës sovjetike atje do të krijohet baza e NATO-s, duke i siguruar Aleancës një vend të rëndësishëm strategjik: vetëm një orë fluturimi nga Siria. Në gusht 2018, NATO-ja njoftoi se do të investonte rreth 51 milionë euro në bazën ajrore në Kuçovë - dikur bazë për Forcën Ajrore Shqiptare. Objekti do të ofrojë karburante, logjistikë dhe mbështetje policore, si dhe trajnime për Aleancën transatlantike. Duket se NATO-ja vendosi ta krijojë bazën e saj të parë ajrore në Ballkan si pasojë e asaj që konsiderohet si një qëndrim i ri ushtarak agresiv nga Rusia, që kulmoi me aneksimin e Krimesë në mars 2014. Në prill 2018, ministria shqiptare e Mbrojtjes, Olta Xhaka dhe sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, finalizuan marrëveshjen e bazës ajrore gjatë bisedimeve në Uashington. Reagimi i Kremlinit ishte i shpejtë: kryeministri rus Dmitri Medvedev e quajti vendimin për ndërtimin e bazës një "provokim", duke paralajmëruar se Moska nuk do "të qëndrojë pranë dhe të shikojë", kurse agjencitë ruse të lajmeve e kualifikuan atë si cenim i "kufirit të vendit" nga NATO. Ishte vetë Rusia ajo që në shtatorin e kaluar mbajti stërvitjen më të madhe ushtarake që nga Lufta e Ftohtë ("Vostok 2018", me 297 000 ushtarë, përfshirë edhe ata nga Serbia. Në gushtin e kaluar, Forcat Ajrore të Serbisë pranuan dy avionë luftarakë rusë MiG-29 dhe ishte njoftuar edhe për blerjen nga Beogradi të sistemit rus të mbrojtjes ajrore S-300, gjashtë avionëve MiG-29 nga Bjellorusia dhe të trans-

portuesve ushtarakë ajrorë - pa pilot - nga Kina.

Javën e ardhshme, gjatë vizitës së presidentit rus Putin në Beograd, pritet nënshkrimi i 20 marrëveshjeve bilaterale ruso-serbe, disa prej të cilave edhe për bashkëpunimin ushtarak midis dy shteteve, në kohën kur Beogradi gjithashtu po mbështet rritjen e forcave të sigurisë të Republika Serpska, kurse kjo e fundit po kërkon nga Moska vendosjen e bazës ruse.

### Skenarët

Skenari më i mundshëm është ai në të cilin Rusia dhe NATO-ja do ta risin praninë e tyre ushtarake në rajon, përfshirë këtu edhe krijimin e bazave përkatëse. Pavarësisht nga referendumi i dështuar në Maqedoni, ajo do të bëhet anëtar i 30 i NATO-s, me çka do të mbyllet unaza jugore e Aleancës Veriatlantike si dhe dy korridoret panevropiane të transportit: VIII (nga Durrësi, Shqipëri deri në Varna, Bullgari); dhe X (nga Salzburgu, Austri deri në Selanik, Greqi) do të jenë tërësisht nën mbrojtjen e NATO-s. Me këtë Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina do të rrethohen plotësisht nga anëtarët e NATO-s, përveç kufirit të tyre të përbashkët.

Serbia do të insistojë për bisedimet për shkëmbim teritorësh me Kosovën, për të penguar këtë proces konsolidues të NATO-s, me qëllim të krijimit të një zone të re konflikti në Ballkan. Bisedimet për shkëmbimin e territoreve janë pezulluar për shkak të kundërshtimit të fortë të kancelares Merkel dhe kryeministres May, ndërkaq të dyja palët negociuese nuk kanë gjasa të arrijnë një marrëveshje deri në mesin e vitit 2019, kur edhe përfundon mandati aktual i Komisionit Evropian. KE-ja është hamundur rreth asaj për ta mbështetur marrëveshjen, me komisionarët Mogherini dhe Hahn, duke i mbështetur ata në një përpjekje të fundit për të konfirmuar një "sukses" në mosmarrëveshje - para se kushtet e tyre të jenë plotësuar.

Është po aq e mundshme që rimilitarizimi i rajonit të jetë pjesë e një skenari më të gjerë të përplasjes strategjike rreth Detit Mesdhe. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet ndikimi i forcuar i Rusisë me bazat e saj ushtarake në Siri, sidomos pas vendimit të fundit të presidentit amerikan Trump për t'i tërhequr trupat amerikane nga atje. Ndikimi i saj dhe prania e pritur në rritje në rajon do ta stabilizojë Evropën Juglindore në vitet e ardhshme. Ekziston droja se Moska mund të nxisë konflikt atje, duke dërguar më shumë refugjatë në Evropë dhe duke destabilizuar qeveritë evropiane. Me Maqedoninë në aleancë, NATO-ja do ta ketë mbyllur krahun e saj në Lindjen e Mesme.





# Narkoza e vizave - mit apo realitet (14)



Shkruan: Agron HOTI

## Lufta për tregje dhe fuqi punëtore

Kur shoh firmat e BE-së që investojnë miliarda dhe zhvendosin zinxhirë fabrikash nëpër vende me popullsi të mëdha, të cilat vijnë nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, atëherë a mund ta mohojë dikush të qëndruarit e qeverive të vendeve të BE-së mbrapa këtyre firmave të mëdha?! Tekefundit, janë qeveritë ato që promovojnë politikën e tyre për t'i rritur eksportet dhe investimet nëpër vende të ndryshme të botës dhe kjo nuk mund të jetë ndryshe.

Pra, kjo do të thotë që çdo establishment politik, pa marrë parasysh se ku në glob, është në shërbim të firmave që janë të interesuara të investojnë nëpër vende të ndryshme në botë. E shtetet e varura nga eksporti i prijnë valles për të pasur qasje në tregje të reja, fatkeqësisht jo gjithmonë brenda rregullave të lejuara. Ndërkaq, rregullat e paljuara në Kosovë quhen korrupsion dhe krim i organizuar, diku tjetër quhen partneritete, lobingje, interes i përbashkët etj.

Vendet e fuqishme tashmë kanë një sfidë të madhe para vetes. Të robotizojnë prodhimin për aq sa munden dhe të sigurojnë fuqi të re punëtore për t'i mbajtur gjallë ekonomitë siç është rasti me Japoninë, Gjermaninë, Korenë Jugore, SHBA, etj. Nëse Kosova dhe rajoni nuk marrin masa nxitëse të mjaftueshme nga BE për zhvillim ekonomik, atëherë është e vetë-kuptueshme që fuqia e re punëtore, më saktësisht ratat e emigracionit, do të rriten kryesisht drejt tregut të BE-së. Për pasojë ikja e fuqisë së re punëtore do të jetë dërmuese për ekonomitë e Kosovës dhe të Ballkanit.

Në anën tjetër as edhe një qeveri e vendeve të BE-së nuk ka arritur deri më sot që të bindë qytetarët e saj lidhur me nevojën imediate për fuqi të re punëtore, e cila duhet siguruar nga vendet e treta (vendet jashtë BE-së), e në rastin konkret nga Ballkani, sepse ka një perceptim që njerëzit nga Ballkani, duke qenë se jetojnë në Evropë, janë shumë më lehtë të integrueshëm dhe pse jo më të pranueshëm në tregun e punës së BE-së.

Qytetarët e vendeve të ndryshme të BE-së, sidomos atyre vendeve

që tashmë hapur po kërkojnë fuqi të re punëtore, nuk duan ose nuk janë ende të gatshëm të shohin të kenë në zyrën e tyre kolegë pune që janë nga vendet kryesisht aziatike apo afrikane. Ka shumë studime që flasin për këtë refuzim. Dhe kjo qasje e ngurtë përbën sfidë për ekonomitë e vendeve që kanë nevojë për fuqi punëtore.

Ndërkohë që politikën e këtyre shteteve - edhe pse të vetëdijshme për nevojat dhe projektionet e shtetit - nuk ja kanë dalë që të bindin qytetarët e tyre për rritje të imigracionit, sepse një ndërmarrje e tillë vetëm sa është duke e rritur të djathtën ekstreme, efektet e të cilës tashmë janë duke i ndier në tërë BE-në, diku më shumë e diku më pak. Japonia është rasti më tipik i shtetit që për të mbajtur gjallë ekonominë nga viti 2019, ndër të tjera, do të fillojë të pranojë fuqi punëtore të pakualifikuar, diçka për të cilën opinioni publik japonez nuk është fare i përgatitur.

Gjermania, edhe pse pati rritje ekonomike nga refugjatët sirianë (kjo sipas Ruchir Sharma në librin e tij "Ngritja dhe rënia e kombeve"), establishmenti politik në ekonominë gjigante të BE-së pagoi çmimin, pra kriza e refugjatëve e dëmtoi rëndë reputacionin e Kancelares Merkel, fuqizoi forcat e djathta dhe dobësoi dukshëm partitë tradicionale gjermane (SPD, CDU, CSU). Ndërkohë që sipas Ruchir Sharmas, Gjermanisë deri në vitin 2030 i duhen nga së paku 1 milion fuqi punëtore e re në vit, diçka që publiku gjerman as që është i gatshëm ta pranojë, edhe pse ekonomia gjermane e kërkon sa më shpejtë fillimin e një veprimi të tillë.

Vetë rezultati i zgjedhjeve në Bavari në tetor 2018 ishte indikator më i qartë i dobësimit të pozicionit të Zonjës Merkel në politikën gjermane. E një

dobësim i pozicionit të Zonjës Merkel do të zbehë rolin e saj edhe në shtyrjen përpara të renditës evropiane. Ngecja e kësaj rend-dite do të jetë me pasoja për të ardhmen e BE-së, pasi zërat kritikë ndaj Brukselit janë duke u rritur gjithandë brenda BE-së e sidomos në vende që kanë probleme me borxh publik dhe vende tjera që janë duke flituar haptazi me Rusinë dhe Kinën.

Por, nuk duhet harruar se kriza e refugjatëve, pikërisht nga kjo mospërgatitje e qytetarëve të BE-së, solli buzë greminës projektin evropian. Rasti i Brexit-it është më tipiku që doli si rezultat i krizës financiare, krizës së refugjatëve dhe nga kokëdhimbja kronike britanike për të mos qëndruar nën juridiksionin e Evropës Kontinentale, që praktikisht i bie juridiksioni gjermano-francez.

## Vakumi në BE

Por nuk duhet harruar që BE do të lëngojë për një kohë të gjatë nga nevoja për fuqi të re punëtore nga jashtë dhe sa më shpejtë që qeveritë e vendeve të BE-së e kuptojnë këtë fakt dhe ua 'shesin' sa më mirë qytetarëve të tyre, aq më mirë do të jetë për ekonomitë evropiane. Çdo devijim nga ky kurs, p.sh. fuqizimi i mëtejshëm i partive me orientime ekstreme të djathta, do të krijojë edhe më shumë probleme brenda BE-së ashtu sikundër që do të dëmtojë dhe dobësojë rolin e BE-së si akter global.

Çdo vakum politik dhe ekonomik që do të mund të ndodhë brenda BE-së do i hapë rrugë Rusisë, e cila me invazionin e saj në Ukrainë, e Gjeorgji, aneksimin e Krimesë dhe përdorimin e energjisë si instrument të politikës ekspansioniste, do të mundohet të çajë "rrethimin" nga perëndimi, të cilin Rusia e sheh si kërcënim të interesave gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Fundja, Rusia me ndërhyrjet në sisteme elektorale të vendeve të

ndryshme të BE-së është e interesuar që projekti evropian të dështojë, në mënyrë që të fillojë ndonjë projekt tjetër Evroaziatik ku Rusia do të kishte rolin kryesor, diçka që është në kundërshtim të plotë me doktrinën amerikane që Euroziamos të bënë asnjë hegjemon, sepse kjo do të sfidonte seriozisht interesat e SHBA-së si fuqi globale.

Çdo vakum politik dhe ekonomik që do të mund të ndodhte brenda BE-së, sigurisht që me shumë maturi dhe precizitet do të mund të përdorej edhe nga Kina, e cila përmes investimeve të mëdha në shkallë globale, përfshirë BE-në, është duke u munduar që t'ia kthejë namin vetes pas asaj që kinezët e quajnë "shekulli i poshtërimin" të periudhës prej vitit 1839 deri 1949 ku fuqitë imperiale dhe Japonia patën pushtuar Kinën. Ky është kursi i Kinës, i cili ka filluar të tregojë frytet e para, e i cili është po ashtu në kundërshtim me interesat amerikane në shkallë globale, e sidomos me rritjen e ndikimit kinez në kontinentin e Azisë.

Fakti që Kina është duke investuar në Ballkan pa pyetur fare për korrupsion dhe krim të organizuar, është tejet sfiduese për BE-në, edhe për faktin se investimet masive kineze, kryesisht përmes kredive, janë duke rritur borxhet publike të vendeve të Ballkanit dhe kjo sigurisht që do rrisë varësinë e rajonit ndaj Kinës dhe firmave të saj të lidhura ngushtë me qeverinë kineze. Për më tepër, investimet kineze kryesisht janë të orientuara në përmirësimin e infrastrukturës së transportit të rajonit të Ballkanit në favor të përsheptimit të qarkullimit të mallrave kineze drejt Evropës Qendrore (zembrës së Evropës) dhe nuk janë duke mbështetur prodhimin si diçka që do të gjeneronte vende pune, diçka për të cilën - krahas përmirësimit të infrastrukturës - ka nevojë më së shumti Ballkani dhe

çdo shtet në botë.

Prandaj, shikuar sfidat nga jashtë që ka BE dhe ato gërryese nga brenda nuk do mend që kërkon një rimobilizim të forcave evropiane për të mbajtur gjallë frymën evropiane, e cila solli BE-në ku është sot. Logjika e përgjashimit nuk do ndihmojë në këtë proces. BE duhet të bindë qytetarët e vet se bashkimi bën fuqinë, çdo fragmentim i BE-së do të jetë fatal për të ardhmen e kontinentit.

## S'merituum regjim të vizave

Prandaj liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës as që ishte dashur të ishte temë brenda BE-së, krahasuar me problemet me të cilat është duke u përballur BE. Projekti evropian nuk ishte izolimi, por zgjerimi, sepse duke u zgjeruar BE arriti këtu ku është sot.

Sigurisht që kushte duhet të ketë, por kur vetë institucionet e BE-së siç është Parlamenti dhe Komisioni thonë që keni plotësuar kushtet dhe nuk veprojnë konform deklaratës, atëherë kjo ul seriozisht kredibilitetin e BE-së jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon dhe më gjerë. Nëse ka ndonjë popull në Evropë që nuk është dashur fare të ketë regjim të vizave, atëherë qytetarët e Kosovës ishte dashur të jenë të parët, pra vizat është dashur të hiqen menjëherë pas luftës në vitin 1999.

Pavarësia e Kosovës i solli paqe Evropës dhe kjo është fakt. E sjellja e paqes dhe stabilitetit në një rajon të trazuar siç ishte dhe ende është Ballkani Perëndimor është gjesti më fisnik dhe human që një popull mund t'i sjell njerëzimit. E Kosova e bëri këtë me shumë mund e sakrificë, prandaj jo vetëm që e kemi merituar qysh moti liberalizimin e vizave, por e meritojmë të futemi në BE para çdo vendi në rajon.

(Fund)

## The Schengen Visa Countries





## Pompeo: Trupat amerikane do të tërhiqen nga Siria

KAJRO, 10 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se tërheqja e trupave amerikane nga Siria, e shpallur nga presidenti Donald Trump, muajin e kaluar, do të ndodhë, pavarësisht kritikave.

"Vendimi i presidentit Trump për të tërhequr trupat tona

është marrë. Do ta bëjmë", tha Pompeo në një konferencë për media në Kajro, së bashku me ministrin e Jashtëm të Egjiptit, Sameh Shoukry.

Pompeo ndodhej në Egjipt në ndalesën e fundit të një turneu në Lindjen e Mesme, i cili ka për qëllim t'i sigurojë partnerët arabë se Uashingtoni

nuk do t'i braktisë.

Pompeo, po ashtu, tha se Uashingtoni do të vazhdojë të përfundojë luftën kundër grupit militant Shteti Islamik, duke shtuar se ShBA-ja do të mbetet partnere e palëkundur në Lindjen e Mesme.

Ai arriti në Egjipt të enjten, pas vizitave në Jordani dhe Irak.



# Trumpi e sheh premtimin për murin si rrugë drejt një mandati të dytë

Trumpi beson se vënia në vend e premtimit të tij të fushatës për murin në kufi, është jetike për synimin e tij për rizgjedhje vitin e ardhshëm, ndërkaq demokratët besojnë po me aq forcë se duhet ta ndalojnë atë për t'i treguar vlerat e partisë së tyre

WASHINGTON, 10 JANAR - Presidenti Donald Trump dhe demokratët e opozitës vazhdojnë të kenë qëndrime të kundërta lidhur me kërkesën e presidentit për murin e kufirit me Meksikën, një përplasje që ka shkaktuar një mbyllje të pjesshme të qeverisë, e cila ka hyrë tashmë në javën e tretë. Trumpi beson se vënia në vend e premtimit të tij të fushatës për murin në kufi, është jetike për synimin e tij për rizgjedhje vitin e ardhshëm. Demokratët besojnë po me aq forcë se duhet ta ndalojnë atë për t'i treguar vlerat e partisë së tyre.

Duke përmendur si argument një krizë në kufirin jugor, presidenti Trump përdori një fjalim televiziv për të bërë thirrje edhe një herë për murin në kufi.

"Demokratët në Kongres kanë refuzuar të pranojnë që ka një krizë dhe kanë refuzuar që t'u jepen agjentëve të guximshëm të kufirit mjetet që u duhen për të mbrojtur fëmijët tanë dhe vendin tonë", tha Trumpi.

Demokratët e kundërshtojnë murin dhe besojnë se Trumpi po e mban vendin peng, thjesht për të mbajtur premtimin e

fushatës.

"Shumë presidentë e kanë përdorur Zyrën Ovale për synime fisnike. Ky president sapo e përdori sfondin e kësaj zyre për të prodhuar një krizë, për të ngjallur frikë dhe për të shmangur vëmendjen nga kaosi në administratën e tij", tha kreu i demokratëve në senat, Chuck Schumer.

Mes atyre që ndoqën fjalimin e presidentit, ishte mbështetësja e tij nga Teksasi, Jeneria Lewis.

"Ishte një lutje. Mua m'u duk një lutje logjike dhe e mbështes atë", tha ajo.

Por ata që janë detyruar të mos punojnë nga mbyllja e pjesshme e qeverisë, janë të irrituar. Një prej tyre është Mike Gayzagiani në Masaçusets, punonjës i pezulluar nga mbyllja e qeverisë "Të mbajnë peng pagat tona, ndërsa zihen me njëri-tjetrin për çështje politike, është e padrejtë. Nuk është e drejtë për askënd", thotë ai.

Donald Trumpi mobilizoi fushatën e tij me një premtim për të ndërtuar një mur për të cilin do të paguante Meksika.

Tani ai është nën presionin e



konservatorëve për ta çuar në vend këtë premtim, thotë analisti Larry Sabato.

"Thelbi i asaj që thanë ishte nëse nuk bën më shumë presion për murin dhe nuk siguron miliarda dollarë për ta ndërtuar atë, atëherë baza jote që ne e përfaqësojmë, nuk do të të mbështesë në vitin 2020", tha ai. Çështja e imigracionit është një nga gurët e themelit edhe për demokratët e opozitës që janë moralisht kundër murit në kufi dhe linjën e ashpër të presidentit, thotë profesori Sabato.

"Bëhet fjalë për trajtimin e imi-

grantëve në kufi. Bëhet fjalë për ndarje të familjeve. Është një çështje e të drejtave të njeriut. Nuk bëhet fjalë thjesht për sigurinë në kufi", thotë ai.

I përballur me mbështetje historikisht të ulët në anketa, dy vjet pasi mori mandatin, Trumpi duket i përqendruar të kënaqë bazën e tij.

Por sipas historianes, Doris Kearns Goodwin kjo është një strategji e rrezikshme.

"Nuk kam parë që presidenti Trump të kalojë nga faza e fushatës tek ajo e qeverisjes dhe baza duket se ka një marrëd-

hënie magjike me të, sipas mendimit të tij dhe ai nuk ka bërë përpjekje për ta kapërcyer këtë fazë. Ai thjesht do të sigurohet që nuk i ka humbur ata", tha ajo.

Trumpi beson se rruga drejt rizgjedhjes është përmes murit të kufirit, që tani për tani nuk është real.

Demokratët, përfshirë shumë prej atyre që duan të kandidojnë për president vitin e ardhshëm, duken po aq të vendosur që të mos ta lejojnë të fitojë, ndërsa fushata për vitin 2020 është gati të fillojë.

## Merkeli rikthehet si fitimtare në Greqi

ATHINË, 10 JANAR - Angela Merkel rikthehet në Greqi për një vizitë dyditore, në vendin që i ka shkaktuar disa prej kokëçarjeve më të mëdha gjatë kohës së saj në krye të fuqisë më të madhe ekonomike të Evropës.

Ky do të jetë një udhëtim me simbolika të mëdha për një udhëheqëse, politikant e së cilës kanë përcaktuar kontinentin, por që ka njoftuar se do të largohet nga posti në fund të mandatit të saj, në vitin 2021.

E, siç thonë edhe vetë zyrtarët grekë, kjo do të jetë një vizitë krejt e ndryshme në humor, ngjyra dhe ton, krahasuar me

vizitat e mëparshme të saj në Athinë, në kulmin e krizës së Eurozonës. Asokohe ishin me mijëra, grekët që dolën në rrugë, disa madje edhe të veshur në uniforma naziste, në shenjë proteste ndaj gruas që konsiderohej gjerësisht si "shkaktarja e vuajtjeve të tyre ekonomike".

Këtë radhë, demonstratat në qendër të Athinës janë të ndalura dhe do të ketë vetëm buzëqeshje dhe përqafime për kancelaren. Ashtu siç do të bëjë edhe kryeministri Alexis Tsipras, dikur një majtist i deklaruar që shpenzonte pjesën më të madhe

të kohës duke kritikuar "Maddame" Merkel.

"Ajo donte të vinte prej kohësh, pasi e konsideron edhe sukses të vetin, faktin që Greqia, dikur në prag të falimentimit, është rimëkëmbur dhe mbetet në zemër të Bashkimit Evropian", tha Tsipras.

Vetë Merkel, para vizitës ka vlerësuar sukseset e Greqisë. Por, në një kohë kur Evropa përballlet me kërcënime të reja, përfshirë rritjen e së djathtës ekstreme dhe demagogjisë populiste, vizita ka si qëllim edhe shërimin e plagëve të së shkuarës, si dhe hapjen e një kapitulli të ri.



AFP Forum ANGELOS TZORTZINIS / DPA



E rrallë

## Noton pesë kilometra për t'iu arratisur policisë

Një peshkatar kenian ka notuar pesë kilometra për t'iu arratisur policisë. Ai u hodh në Liqenin Viktoria në mënyrë që t'u shpëtonte oficerëve të armatosur detarë të Ugandës, që i konfiskuan varkën gjatë një ekspedite peshkimi pranë plazhit të Majanjit. Ben Wandera



nga fshati Buduongi ka thënë se notoi rreth pesë kilometra për ta shpëtuar jetën e tij. Ai tregoi se tre kolegët e tij u arrestuan dhe u dërguan në një kamp ndalimi në Ugandë.

## BARSOLETA E DITËS



Dy shokë:

- Pse e lëshove të fejuarën tënde? Mos të pengojë që filloi të bartë syze?
- Jo bre, nuk e lëshova unë, por ajo më lëshoi mua kur për herë të parë i vendosi syzet në sy.



## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



## FOTO E DITES



Kështu është dukur nga bora të enjten Sheshi "Zahir Pajaziti" në Prishtinë.



### Në ora 17:30 "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

### Në ora 19:30 "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



## E jashtëzakonshme

### E ndalojnë trenin për të shpëtuar një kafshë të groposur nga bora

Një tren i dëborës në Austri po lironte shinat nga reshjet e mëdha të dëborës në zonë, kur dy shoferët hekurudhorë dëgjuan rënkime nga dhembja me zë të lartë dhe panë një kafshë të mbuluar nga dëborë që nuk mund të lëvizte. Kështu ata ndaluan trenin dhe



zbritën me lopata dhe gërmuan për ta nxjerrë nga bora dhinë e egër.



### Në ora 22:00 "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Sot jeni aq komod sa nuk keni aspak dëshirë të reagoni apo të vendosni. Do ta lini gjithçka në dorë të të tjerëve dhe po ju pëlqen kjo ndjesi.</p>	 <p><b>DEMI</b> Pasi t'i keni vendosur objektivat tuaja do të filloni të veproni. Nuk do ta keni të lehtë të mposhtni disa pengesa të papritura.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Keni ditur të zgjidhni më të mirën nga miqtë tuaj dhe gjithmonë keni neglizhuar disa kapriçio të tyre që nuk i prishin punë askujt.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Gjërat e vogla janë ato që do ta bëjnë lumturinë tuaj sot. Partneri është bashkudhëtari juaj në ëndrrën për të ardhmen së bashku.</p>	 <p><b>LUANI</b> Ato që thuhet në momentin e gabuar mund të prekin njerëz që për ju janë vërtet të rëndësishëm. Sot do të pendoheni për një fjalë të thënë.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Do t'ju duhet të jeni mjaft të programuar sot. Punët dhe agjenda e ngarkuar që keni nuk do t'ju lënë asnjë çast të lirë për t'u çlodhur.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Një ditë e zhurmshme kjo e sotmja e karakterizuar nga humori dhe të qeshura pa fund. Familja është streha juaj e ngrohtë në çdo çast.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Arti dhe muzika janë ato që do t'ju shoqërojnë përgjatë gjithë ditës. Sot do të ecni me zemër dhe jo me arsye.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot po shpresoni të mos keni vizita të paprogramuara, por do të ndodhë krejt e kundërta. Do t'ju ngatërrohen situatat dhe personat.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Biznesi dhe marrëveshjet janë pika juaj e fortë sot. Do t'ju kërkojnë ndihmë dhe do të dini të jepni atë që do t'ju kërkohet pa shumë problem.</p>	 <p><b>UJORI</b> Entuziazmi juaj që fillon që në orët e para të mëngjesit do të lërë pa fjalë bashkëpunëtorët tuaj. Vitaliteti që ju shoqëron sot do të bëjë të merrni vendime interesante.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Ditë e qetë dhe plot harmoni me personat që ju qëndrojnë pranë. Nuk merrziteni nga askush dhe u ktheni përgjigje të gjithëve që kanë pyetje.</p>




## Fansat e Khloes thonë se ajo ka ndryshuar



Fansat e Khloe Kardashianit, sipas "Hollywoodlife", thonë se ajo duket më ndryshe se herëve të tjera. Kohët e fundit ajo ka

publikuar një fotografi në rrjetet social, e cila ngjalli debat te fansat të cilët thanë se ajo ngjanë shumë me motrën e saj më të vogël Kylie Jenner.

## Zac Efron bëhet biond



Aktori hollivudian Zac Efron të mërkurën ka publikuar një fotografi teksa është duke kryer

aktivitete sportive. Në atë fotografi shihet se Efron ka ndërruar ngjyrën e flokëve, është bërë biond.



## Hailey dhe Justin shtyjnë ceremoninë e dasmës

Çifti Bieber ka qenë duke e planifikuar ceremoninë e dasmës ku të pranishëm do të bëjnë familjet dhe miqtë e tyre më të afërt, që në shtator kur nënshkruan dokumentet e martesës. Madje pati disa fjalë që thoshin se do të zhvillohej në fillim të janarit, por ata ende nuk janë gati për të

qëndruar përpara pritit e t'i shkëmbejnë unazat. Burime të afërta me ta zbulojnë se Justin dhe Hailey duan ta bëjnë ceremoninë sa më shpejt, por nuk kanë mundur ta organizojnë pasi njerëzit e afërt me ta janë shumë të zënë dhe nuk kanë mundur të gjejnë një datë kur të gjithë mund të vijnë.

## Future tregon datën e publikimi të albumit




Reperi amerikan Future ka paralajmëruar publikimin e albumit të tij. Më 16 janar

reperi pritet ta publikojë albumin, ndërsa ai tashmë ka publikuar trilerin e dokumentarit me të njëjtin emër.



# REPORTAZHE



## ERNEST HEMINGWAY

Ernest Hemingway (21 korrik 1899-2 korrik 1961) ishte novelist amerikan, shkrimtar i historive të shkurtra dhe gazetar. I përket shkrimtarëve të periudhës klasike të letërsisë amerikane. Heminguej përfaqëson në mënyrë të shkëlqyer realizmin letrar në ShBA. Stili i tij ekonomik dhe i nënvlerësuar kishte një ndikim të fortë në fiksim në shekullin 20, ndërsa jeta e tij e aventurës dhe imazhi i tij publik ndikuan në gjeneratat e mëvonshme. Hemingway prodhoi pjesën më të madhe të veprës së vet midis viteve 1920 dhe 1950 dhe fitoi Çmimin Nobel në Letërsi në vitin 1954. Botoi shtatë romane, gjashtë koleksione me histori të shkurtra dhe dy libra jofiksionalë.

### Ballkani si Ontario: Tablo paqe, e jo lufte

TORONTO DAILY STAR/  
16 TEJTOR 1922

Kisha vetëm njëzetë minuta për ta zënë Simplon Orient Expressin, që po nisej nga Gare de Lyon, në cepin tjetër të Parisit, për të gjarpëruar drejt Kostandinopojës - dhe kishte vetëm një taksì. Mjaftonte vetëm ai, por halli ishte se taksia kishte një behane. Shoferi ishte pijanec. Dhe derisa po çanim herë andej, herë këndej, nëpër llugën e trafikut të Parisit, anova trupin kah dritarja dhe pashë qafën e kuqe të shoferit, u luta që të mos godisnim askënd. Kur mbërriti para sheshit të madh, shoferi, me saktësinë e një pijaneci, gjeti një birë midis autobusëve të gjelbër dhe taksistëve që po u binin borive, dhe u përbiuam diqysh anash trotuarit.

"Volia!", - bërtiti shoferi dhe, duke bërë gjeste të tjera dramatike, ma mori valixhen prej ulëses anash

meje. E hodhi në trotuar.

Vetëm tani i kuptoj njerëzit e fiksuar pas gjërave të tyre të dashura. U shtanga. Madje ka një shprehje për raste të tilla: "Nuk bëra vërr me gojë".

Në valixhe kisha makinën e shkrimit, për të cilën gazetari kujdeset më shumë për të sesa nëna për fëmijën e saj, ose një pronar "Fordi" për makinën e tij, ose se një futbolist për këmbën e djathtë.

"Pijanec! Makina ime e shkrimit është në të", nxora vërrin unë.

Taksistit i ishte davaritur humori heroik dhe kishte marrë veten. Provoi të ma shtrëngonte dorën.

"Monsieur, mund të më quash njëqind herë derr a deve. E meritoj. Por isha i ekzaltuar!"

Nuk kisha tjetër punë më të mençme, pos ta zija trenin. Kalova portën për t'i rënë trup stacionit të gjatë të fëlliqtë me britmën e shoferit që nuk më ndahej prapa shpinës: "Nuk jam i dehur. Jam i ekzaltuar!"

Punë e madhe! Rezultati ishte i njëjtë, çanta e makinës së shkrimit ishte e shtrënguar mirë dhe do ta hapja vetëm kur të mbërrija në Kostandinopojë.

Këtë histori do ta hidhja shkar-ravtishëm me laps në letër, përderisa treni i gjatë bojëkafë i Orient Expressit do të gjarpërojë ngadalshëm nëpër Evropë, nëpër kufij imagjinare, përgjatë maleve dhe matanë fushave me të mbjella drejt Kostandinopojës dhe Shkodrës, ku një turk biond, shtatshkurtër dhe çehrezi, me një ekspeditë ushtarake prej tridhjetë mijë burrash dhe një populli të bashkuar prapa vetes, ua dikton kushtet aleatëve të cilët e ndiqnin dy vjet më parë si bandit.

Kupenë e ndaj me një riosh serb, i cili ndiqte shkollimin në Boston. Muhabeti me të zhvillohet pak a shumë kështu: (me një anglishte të çalë, vërejtje e përkthyesit.)

"Say. Wattaya think I paid for this coat in Paris? Hundertnifteen francs. Pretty good? Huh? Wanta see picture my girl? Some girl? Huh? I got a better-looking girl but her picture's in my trunk. Say look at that Italian officer. Don't he look just like a woman? I bet he wears corsets. Don't tell me a guy dresses like that can fight. Say ain't he a scream?"

E shoh se oficeri italian, i cili mban syze teke, me tri shenja plagësh dhe, përveç dekorimeve në vendlindjen e tij, ka edhe një kryq ushtarak britanik.

"Say they ought to take birds like that out and shoot them", says the Serb.

Reflektoj dhe e kuptoj se pikërisht kështu kishin vepruar.

I biem nëpër fushën e gjelbër, bojëkafë, të pasur të Lombardisë. Peizazhi përthyeret prej plepave të Lombardisë dhe pritret prej gardhiqve të trasha të zeza. Përtej fushave të pasura të orizit dhe shtretërve të thatë me guralecë të mëdhenj dhe të bardhë sa të vezëve të pulës, na shfaqet një kambanore e madhe, e bardhë dhe e pastër që na zë diellin. Qetë ecin rugëve të pluhurosura dhe një hardhucë zvarritet kurrizit të murit derisa treni kalon anash tij.

Krejt fushat e Evropës janë të gjelbra, të arta dhe të pjekura në kohë korjesh e vjellesh. Pjesa e Serbisë nëpër të cilën po kalojmë duket si Gadishulli i Niagarës. Ka njëfarë mjegulle shtatori të vonshëm që ka rënë nëpër fusha, dhe prej se kalu-

am kufirin kroat në mëngjesin e sotëm, po përshkujmë terren që duket si Ontarioja Lindore. Është e zorshme të besosh se ky terren i pasur, i këndshëm për bujqësi, është Ballkani famëkeq. Megjithatë, është kjo bukuri, dhe derisa e përshkoni, mund të shihni se si dashuria për tokën mund t'i nxisë burrat të luftojnë. Është çështje toke, e fushave të misrit dhe duhanit të zverdhur, e ahishteve dhe e tymit të oxhaqeve, çështje e burimit të pashtershëm dhe lidhja e nyshme me to, janë ato që kanë shkaktuar krejt luftërat e drejta dhe kurrë nuk mund të ketë paqe në Ballkan derisa një popull mban tokën e popullit tjetër - pavarësisht cילו justifikim politik.

### Rekrutimi i "trajtoj shtë"

KANSAS CITY STAR/  
18 PRILL, 1918

Katër burra qëndronin para zyrës së rekrutimit në Rugën e Dymbëdhjetë në Avenynë e Madhe fiks në 7:45, mëngjesin e sotëm, kur para syve u doli rreshteri. Një burrë vigan, faqekuq me kanotiere kaki, ishte i pari në krye të shkallëve. "Unë jam 'trajtoj shtë'", bërtiti burri. "Ajo mace në poster nuk ka lidhje me mua. Ku mund t'u bashkohem tankistëve?"

"Duhet ta prisni kolonelin Cooter", ia ktheu rreshteri. "Është ai që vendos nëse do t'i 'trajtosht shtë ose jo'". Burri trupmadh priti para derës. Kah ora nëntë, tridhjetë burra zunë korridorin e katit të tretë. Burri trupmadh nuk po i ndahej derës. Menjëherë prapa tij ishte një burrë thinjosh me një palë kostume të perar ngushtë, kollare të purpurte, çorape të ngushta dhe një mindil të mëndafshhtë me një vijë të purpurte që lëshohej teposhtë xhepit të setrës.

"Më ka kaluar mosha e rekrutimit dhe nuk ka rëndësi profesioni im", tha ai. "Kurrë më parë nuk më ka shkuar mendja t'i përvishem luftës, por ndryshe është kur vjen puna te tanket. Ma merr mendja se mund t'i 'trajtoj shtë'".

Turma po rritej ngadalë. Kah ora dhjetë u bënë rreth dyzetë vullnetarë. Disa prej burrave pëshpëritnin, të tjerë ishin lëshuar në muhabet të zhurmshëm ndërmjet vete. Burri trupmadh, të cilit djersët po ia lanin fytyrën lumë, nuk po i nda-



hej derës. U mundua të vërshëlente, por buzët nuk po e dëgjonin. E lëshoi trupin në njëren këmbë, pastaj edhe në tjetrën. E fshiu fytyrën me një mindil dhe ia hodhi një shikim zhbirues krejt turmës.

"Dukej se po plaste prej mjedisit që po ziente, por këmbët i kishte akull", u dëgjua komenti i një mekaniku.

Dhe pasi burri trupmadh u dha këmbëve, ia mbathi edhe një pjesë e turmës. Një student nuk po e lëshonte nga dora një libër gjeometrie. Dy rioshë, të veshur pa shije, thanë: "Pse s'e marrim nga një birrë!" Një burrë, pa e çelë gojën, u largua pa rënë në sy.



"Nuk e duroj dot këtë shtirje të madhe", theksoi mekaniku. Por shumica e aplikuesve nuk lëvizën vendi. Një djalosh me kanotiere ushtrie shpjegoi: "Është zoçka ime. Isha pjesë e gardës dhe ajo ma drodhi disa. Askush nuk mund t'ia dredhë një tankist, mua kështu ma merr mendja".

Opinionit i shumicës së burrave u tha zëshëm prej një nëpunësi. "Nuk marr vesh kurrëgjë në traktorë ose makineri, por mund të mësohem të punoj me mitraloz dhe t'ia dal mbanë. Mik, shpresoj se do të pranohem".

Një burrë shtatshkurtër me xhama të dyfishtë syzesh tha: "S'ma merr mendja se do të më marrin. Ma ha mendja se s'jam i dobishëm. Por dua ta provoj. Është mundësia ime e fundit. Krejt po ma mbyllin derën". Kur doli koloneli Frank E. Cooter, zyrtar kompanisë së Hekurudhave i Qytetit të Kansasit, ia ktheu ai.

"Pse dëshironi të bëheni pjesë e ushtrisë?" "Dua ta përjetoj ndjenjën e aksionit dhe t'ia marr ngutshëm dorën". Koloneli Cooter e pranoi.

"Të këtij soji janë të gjithë" theksoi koloneli. "Kjo është arsyeja pse kanë ardhur. E jo premtimet për paga të larta ose shërbimi, por e







vërteta që e tregojnë për aksionin dhe rrezikun. 'Të dish dhe të guxosh', do të ishte një slogan i mirë. Shërbimi i menjëhershëm, ngritje e shpejtë në detyrë dhe aksioni, aksioni është çfarë i sjellë këtu. Ata janë soji më i mirë i burrave për ushtarë".

Përveç Ecklundit, u pranuan në shërbim atë mesditë edhe gjashtë burra të tjerë.

### Drejt trim bëhet tankist

KANSAS CITY STAR/  
21 PRILL, 1918

"A keni pasur ndonjëherë përvojë me mjete motorike me gaz?" - pyeti dje koloneli Frank E. Cooter, zyrtar special për tanke në qendrën e rekrutimit ushtarak në Rrugën e Dymbëdhjetë në Avenynë e Madhe.

"Mund të thuhet se kam njëfarë përvojë", ia ktheu William A. Whitman, i cili jeton në shtëpinë numër 914 në Rrugën e Nëntë të Lindjes. "Kam drejtuar një 'Blitzen-Benz' katër vjet me radhë nëpër autostradat e Chicagos, New Yorkut, Cincinnati dhe Los Anxhelosit. Mund ta cilësoni garën time me Ralph Mulfordin në Reno si përvojë me motor me gaz. Ose kohën kur barka e vjetër po fluturonte rreth 200 kilometra në orë në shtegun e Gjirit Sheepshead, ose kur Bob Burman u mbyt në kuvertin e madhe dhe unë u përplasa menjëherë pas tij. Ato ishin përvojat e mia me motor me gaz".

"Por, a keni pasur ndonjë përvojë ushtarake? - e pyeti koloneli Cooter. "Paj, mirë, jo në ushtri të rregullt. U ngarkova me gradën e kolonelit në ushtrinë e Nikaraguas në luftën kundër Hondurasit më 1909. Isha kapiten mitralozi me Maderon kur ai e hoqi qafe Diazin. Amerikani i parë që do të hynte në Juarez. Pyeteni Pancho Villan, ai e di më mirë. Por asnjëra prej atyre përvojave nuk ishin tamam ushtarake. Jam ngarkuar me detyra edhe në disa revolucione të Amerikës Qendrore. As atje përvojat nuk ishin krejt ushtarake".

Koloneli Cooter ia shtyri para një fletë të bardhë. "Nënshkruaje në boshllëkun me pika", tha ai. "Bash soji yt na duhej!"

"Paj, mirë, nuk jam matur në gara

prej shtatorit në Gjirin Sheepshead dhe, mbase, më duhet pak kohë derisa t'ia marr dorën, por nuk besoj se duhet t'u jepet aq shpejt tankeve. Përveç kësaj, kam pak telashe me dhëmbët. Por nuk kam asnjë fije dyshimi se do të rekrutohem për tankist".

Koloneli Cooter do ta njoftojë Washingtonin për kërkesat për dhëmbët.

Përveç kuotës së rregullt për mekanikë, berberë, shitblerës makinash, banakierë dhe studentë, të cilët aplikuan dje, aty ishte edhe Maynard Bushi, 38 vjeç, instruktor gazetarie në Kolegjin Politeknik. Ai nuk do të rekrutohet deri javën tjetër, kështu që do të ketë kohë sa për të gjetur një zëvendësues në kolegji.

Aplikacione janë pranuar prej shumë studentëve të Universitetit të Kansasit, të cilët dëshirojnë të rekrutohen. Edhe instituti nga Manhattani, "Sigma Alpha Epsilon Chapter", ka shkruar se shumë pjesëtarë të tij do të donin të rekrutoheshin. Telegrame dhe letra kanë ardhur dje prej të gjitha vendeve për të shërbyer në sektorin e tankeve.

116 burra janë pranuar prej kolonelit Cooter gjatë javës për t'u radhitur menjëherë krah ushtarëve të rregullt. 19 janë pranuar vetëm dje.

### Luftë, art dhe vallëzim

KANSAS CITY STAR/  
21 PRILL 1918

Jashtë një femër po ecte nëpër borë e shi përgjatë trotuarit të rrugës së lagur e të ndriçuar zbehtë.

Brenda, në Institutin e Arteve të Bukura, në katin e gjashtë të ndërtesës së YWCA-së numër 1020, në rrugën "McGee", një grumbull ushtarësh qejfli të kampit të Funston and Fort Leavenworthit trokisnin dyshemenë derisa vallëzonin me vajzat nga Shkolla e Arteve të Bukura, ndërkaq një riosh esëll po shkrihej me muzikën më të re jazz - sytë ua kishte ngulur valltarëve qejfli. Në një qoshe, një burrë civil kishte shtruar muhabetin për Whistlerin me një vajzë flokëzeze, çehra e së cilës tregonte aprovim. Burri ishte anëtar i kolonisë artistike në Chicago para se të kryste lufta. Tre burra nga Funstoni po sha-

lakateshin krah për krah përgjatë murit përderisa po shikonin ekspozitën e pikturave të artistëve të qytetit të Kansasit. Pianisti përnjëherë i çoi duart nga tastet. Valltarët duartrokitën, brohoritën dhe ai notoi në "The Long, Long Trail Awending". Një tetar i këmbësorisë, tekta po vallëzonte me një vajzë lozonjare me fustan të kuq, ia afroi kokën për të sajën dhe i rrefeu diçka për një vajzë në Chautauqua. Në korridor, një grup vajzash rrethuan një pjesëtar të artilerisë, dy koka më të gjatë se to, dhe duartrokitën burrin që kishte sfiduar kolonelin, i cili kishte harruar parullën. Muzika u ndal përsëri dhe pianisti me solemnitë u ngrë dhe iu bashkua të tjerëve për ta çuar një gotë.

Një grusht burrash u turr drejt vajzës me fustan të kuq për ta shoqëruar në vallëzimin e radhës. Jashtë gruaja po ecte përgjatë trotuarit të lagur me ndriçim të zbehtë.

Ishte vallëzimi i parë për ushtarët që do të ishin nën komandën e Shërbimit të Kampit Komunitar të Luftës. Dyzetë vajza të shkollës së artit, nën shoqërinë e zonjës së pjekur Winifred Sexton, sekretare shkolle dhe zonjës J. F. Binnie, ishin mikpritëset e ndejës. Ishte ide e J. P. Robertsonit të Shërbimit të Kampit Komunitar të Luftës dhe njoftimi u qe dërguar edhe komandantëve të kampit për festë ushtarëve në largim. Posterët e dizajnuar nga studentet ishin vendosur nëpër trena ndërurbanë në Leavenworth. Vallëzimi i parë do të pasohet prej të tjerëve nëpër klube e shkolla të ndryshme anembanë qytetit, tregon zoti Robertson.

Pianisti u kthye përsëri në ulëse dhe ushtarët u vërsulën në kërkim të partnerëve. Ndërkohë, ushtarët i qerasën vajzat edhe me pije frutash. Vajza në të kuqe, rrethuar prej një grupi burrash në uniforma ushtarake, u mbështet për piano, me burrat dhe vajzat e tjera që u mblodhën përreth, para se t'ia krisnin këngës deri në mesnatë. Ashensori ishte prishur, kështu që turma e qejflinjve u desh të lëshohej truq teposhtë shkallëve përgjatë gjashtë kateve dhe gjithsecili hyri vrullshëm në makinat motorike. Pasi shkoi edhe makina e fundit, gruaja eci nëpër borë e shi përgjatë trotuarit të lagur dhe hodhi shikimin kah dritarja pa dritë në katin e gjashtë.

### Gratë ua blejnë veshmbathjet burrave francezë

TORONTO STAR WEEKLY/  
11 MARS, 1922

Më në fund u mor vesh puna e pantallonave në forma balonash, të ngushta te kyçet, të punëtorëve francezë. Për vite me radhë njerëzit kanë hamendësuar pse punëtori francez donte t'i rrate këmbët në pantallonat aq të ngushtë, sa që zor se mund t'i nxirrte kur i zhvishte. Tani u mor vesh. Fajin nuk e kanë burrat. Po ua blejnë vetë gratë.

Krejt së fundi në kohën e drekës, fabrikat franceze po bëjnë alamet tregtie me veshmbathjet e burrave. I këmbëjnë palltot, pantallonat, kapelat e këpucët. Është një revoltë kundër feminizmit. Për teshat e

punëtorit francez prej se mbahet mend, është kujdesur gruaja e tij. Dhe tani burri francez ka nisur të protestojë kundër kësaj shprehie.

Dy francezët të cilët kishin shërbyer në të njëjtin regjiment bashkë dhe nuk e kishin takuar njëri-tjetrin prej kohës së demobilizimit, nxorën dje zemërimin e madh në një autobus kur u takuan krejt rastësisht.

"Çka janë ato flokë, Henri!", - tha njëri.

"Gruaja, shok i vjetër, ajo m'i qeth. Po, edhe ti, çka ke bërë me ato tuat? A nuk janë tepër elegante?!"

"Gruaja, edhe mua. Edhe mua m'i qeth ajo. Plako, më thotë se berberët janë derra të fëlliqtë por, në fund, duhet t'ia jap po atë bakshish që do t'ia jepja berberit".

"Qy flokët! Flokët janë halli më i vogël. Hidhja një sy këtyre këpucëve".

"Shoku im i vjetër, i gjori ti. Është e pabesueshme".

"Është sistemi i gruas sime. Shkon në dyqan dhe thotë: 'Më duhen një palë këpucë për mon mari. Jo prej të shtrenjtave. Këmbët e mon mari janë larg më të mëdha se të miat, ma merr mendja, dhe larg më të gjera. Këto do t'i rrinin për mrekulli. Mbështilli". Plako, është e tmerrshme!"

"Edhe mua më veshi me teshat pazzari. Çka nëse nuk më bien tamam. Janë bon marché. Megjithatë, është kuzhinieri e hatashme. Nuk ia gjen shoqen. Mik i vjetër, do të duhej ta provojë vetë ndonjë prej atyre thesareve që i gatuan".

"Edhe imja, plako. Një kuzhinieri që nuk paguhet me para. Kuzhinieri e dorës së parë. Tekefundit, ç'rëndësi kanë teshat?"

"Është e vërtetë. S'e luan topi! Është problem i vogël".

Andaj, pavarësisht tregtisë që po bëhet nëpër fabrika dhe shpërthimit sporadik të protestave, sundimi i feminizmit mbase do të vazhdojë.

### Meka e mashtruesve në kryeqytetin francez

TORONTO STAR WEEKLY/  
25 MARS, 1922

Parisi është Meka e dallaveraxhinjve, e mashtruesve dhe e orvatjeve prej muzikës deri te rrahjet me para. Ju mund t'i gjeni këtu valltare më të famshme amerikane për të cilat kurrë nuk keni dëgjuar në Amerikë; valltare më të njohura ruse prej të cilave rusët i kanë çuar duart; dhe larg më shumë kampionë të rrahjeve me para, të cilët

ishin çuna para se ta këpusnin oqeanin, për një kilometër katror se kudo tjetër në botë.

Kjo gjurulldi frymon sherri i provincialitetit të skajshëm të popullit francez dhe sherri i shtypit francez sylesh. Gjithsecili në Kanada di emrat e gjysmës së një duzine ushtarësh dhe burrështetasish francezë, por kurrkush në Francë nuk di ta thotë as edhe një emër të vetëm të një gjenerali a burrështetasi kanadez, ose kush është tani prijatar i qeverisë kanadeze. Kur e them kurrkush, fjalën e kam për qytetarët e rëndomtë; dyqanxhinjtë, pronarët e hoteleve dhe shtresën e përgjithshme borgjeze. Ta zëmë, pastruesja ime u tmerrua dje kur i tregova se në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada është i ndaluar alkooli. "Pse kurrë nuk kemi dëgjuar për këtë punë?", - pyeti ajo. "A është ndaluar edhe me ligj? Atëherë, çfarë mund të pinë burrat?"

Një rioshe amerikane paralajmërohej bujshëm në reklama në sallat muzikore të Parisit si "valltarja më e mirë dhe më e dashur e Amerikës". Kurrkush prej njerëzve të cilët porsa po zbrisnin në Paris nga aeroplanët e Shteteve të Bashkuara nuk e kishte dëgjuar as edhe një fjalë të vetme për të, por parisienët u turën se s'u pritej që ta shihnin "Yllin" amerikan. Më vonë u mor vesh se ajo kishte para disa vjetësh një pjesë të vogël në një shou muzikor amerikan.

Rusët e kanë vërshuar qytetin. Ata ia dalin pothuajse në gjithçka e gjithkund, sepse është punë e lehtë për një rus të pretendojë sepse s'ka çka thotë në Rusi; nuk ka kurrfarë mundësie për ta analizuar reputacionin e rusëve tani. Andaj, kemi valltare e mrekullueshme ruse, pianistët, flautistët, kompozitorët dhe organistët e mrekullueshëm rusë - krejt njësoj të këqij.

Jack Clifford, i cili ia kishte qitur vetes namin e kampionit zezak të peshës së rëndë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë, ishte mrekullia e fundit që zgjat tri ditë në Francë. Ai u bishtnonte luftërave me çfarëdo kundërshtari dhe kërkonte shuma të pakapshme parash për të boksuar, por ishte i gatshëm të ndeshet me Carpentierin nëse do t'i ofrohej një shumë e majme. Asnjë amerikan nuk ia kishte dëgjuar kurrë emrin, por evropianët desh po e hanin.

(Marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")





# DY FJALË PËR GJERGJIN E SULAJT

Analizë pikurës portret të autorit Agim Sulajt, "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"



DIJE DEMIRI-FRANGU

Vepra portret "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" e Agim Sulajt është vepër me temë historike, me bartje të një pjese të kujtesës sonë kolektive. Pavarësisht prej këtij pikëtakimi, autori e distancën idealizimin si intencë, himnizimin si diskurs tipik për figurën e tij dhe këtë e bën duke krijuar një portret realist, me imazhin dhe elementet të cilat e shoqërojnë kryetrimin në foton e "Historisë së Skënderbeut" të Marin Barletit.

Portreti i Gjergj Kastriotit Skënderbeut që e keni në kopertinë të kësaj reviste, përfshin kokën dhe supet e kryetrimin, me ngarkesë meditative, vendosur në një pozitë statike, sikur i fundosur në një vërshim, por i palëkundur dhe symbyllur, pozitë e cila provokon shikuesin të hulumtojë më shumë sesa që ofron shikimi i parë i këtij portreti.

Portreti krijon imazhin se heroi po e përjeton një gjendje - ëndërr apo mendim të rëndë që i reflektohet në fytyrë, që në këtë rast del elementi bazë i personalitetit të tij. Portreti nuk është i pajisur me mburojë e shpatë, ndaj këtu autori Sulaj, gjithë bëmat, strategjitë, luftërat e fitoret e tij, i ka koncentruar në pozitën e shpatullave, krahëve dhe përmes këndit, planit të ndriçimit që na orienton kundrimin në detaje - si është përkrenarja - së cilës Sulaj më së shumti i jep dritë, pastaj elementet e fytyrës për të mos qenë dorështrënguar as këtu me nuancat plot dritë të subjektit.

Duke qenë e vendosur në një sfond të nuancuar me një të hirtë jo të pastër, sfond i cili përmes aftësisë së nuancimeve merr formën e një lëvizjeje të ajrit, që na kujton simbolikisht furtunat historike, krijohet një kontrast mes subjektivit dhe sfondit ku, para se gjithash, ndihen reflektime mbi pozitën psikike të subjektit, duke nxjerr qëndresën, përkundër rrezikut të jashtëm që vjen si një valë-hije, e turbullt, e paqartë, por me një pësjtjellim të shpejtë.

Bile, kjo valë e turbullt, pos prapaskenës, ka vërshuar edhe gjysmën e portretit, e ka vërshuar deri në gjoks kryeheroin.

Rënia e dritës në fytyrën e subjektit sugjeron dhe gjeneron asociacione e ide mbi portretin dhe ideologjinë që bartë ai si mbret i një kombi dhe strateg luftarak. Drita pra është frontale dhe e dritës përkrenaren dhe tiparet e fytyrës, me qëllim të bartjes së optimizmit, simbolokisht është një mendim me një shtegdalje, pavarësisht prej sfondit të paraqitur në formë të një pësjtjellimi mjegulle apo si një vërshim i errët, që ngjet me një sulm që mund të bëhet tradhtisht ngaqë vjen nga prapa. Duke qenë se fytyra e subjektit është në fokus dhe e dritësuar, portreti nuk lë imazhin e ndonjë trishtimi apo frike, pos të një meditimi apo të një kërkimi të një zgjidhjeje të mençur, por derisa sytë janë mbyllur, mendimet janë problematike.

Karakter i personazhit ndërtohet pikërisht në këtë gjendje, të një qetësie përpara furtune. Ajo që e optimizon subjektin është shqiponja, elementi më i theksuar i portretit, gjë që e çkodon mendimin e personazhit krahas përkrenares, që si element identifikues i personazhit, ka më së shumti dritë, në kuptimin e ngjyrës, mes të kaltrës së qiellit dhe mjegullës që mund të ketë rënë në këtë qiell. Kjo mund të merret edhe si një simbol sepse përkrenarja e jep dritën e qëllimit, besimit dhe vezullimit, kurse sfondi është prapaska politike e kohës, turbullirë dhe valë të trishta, të papërcaktuara si ngjyrë pa identitet të qartë. Gjergji duket i ulur si para një projekti që do ta ndalte vërshimin që vjen nga prapa sesa i ulur në fron. Por, derisa vërshimi marrë teposhtë dhe është bërë gati për vërshim, autori i pikurës, me invencion artistik, përmes ngjyrës përforcon qëndrimin e personazhit heroik, i shton stoicizmin në pozitën që ka, sikur e ka ngulur me

shqiponjës si dekor ideor, përcakton në këtë portret edhe dimensionin fizik të heroit. Fillimisht, sytë e mbyllur duken sikur janë fundosur në ndonjë lutje, e thënë me zemrën e heshtjes dhe mëdyshjes por, përkundër syve të groposur në mendim, elementet e tjera të fytyrës shndritin dhe japim pamje karakteristike dhe vizionare për shporrjen e brengës. Mendoj se vërshimin e së keqes në trojet e Arbërit, në trojet e Gjergjit, autori ka provuar t'i qesë në pah jo vetëm përmes një meditimi të thellë, por edhe përmes pikurimit të pelerinës me të njëjtat nuancime të ngjyrës së sfondit - valës vërshuese.

Heroi, personazhi hero, është gjysmë i fundosur. Ai po e ndjen një rrezik dhe përmes meditimit po provon t'i mobilizojë forcat e brendshme, ato mendore e fizike, për një nismë tjetër. Ky është mendimi që ruan ende dritë në përkrenaren e tij dhe në shqiponjën që nuk është në pozitën e një mburoje sa është një peshë përgjegjësie, ku mbështetet koka e heroit - meditimi i tij, rreth flamurit pra, rreth atdheut. Heroi këtu nuk është në kulmin e tij.

Korrespondimi artistik i mjekrës me shqiponjën, që janë në kufi me njëra-tjetrën, reflekton madhësinë e shqiponjës në fytyrën e personazhit dhe i jep identitetin e mendimit, njëkohësisht i shërben autorit edhe si dekor, që thyen e bën kontrastet në portret. Realisht, pikurimi i tillë i

shqiponjës si dekor ideor, përcakton në këtë portret edhe dimensionin fizik të heroit.

Fillimisht, sytë e mbyllur duken sikur janë fundosur në ndonjë lutje, e thënë me zemrën e heshtjes dhe mëdyshjes por, përkundër syve të groposur në mendim, elementet e tjera të fytyrës shndritin dhe japim pamje karakteristike dhe vizionare për shporrjen e brengës. Mendoj se vërshimin e së keqes në trojet e Arbërit, në trojet e Gjergjit, autori ka provuar t'i qesë në pah jo vetëm përmes një meditimi të thellë, por edhe përmes pikurimit të pelerinës me të njëjtat nuancime të ngjyrës së sfondit - valës vërshuese.

Heroi, personazhi hero, është gjysmë i fundosur. Ai po e ndjen një rrezik dhe përmes meditimit po provon t'i mobilizojë forcat e brendshme, ato mendore e fizike, për një nismë tjetër. Ky është mendimi që ruan ende dritë në përkrenaren e tij dhe në shqiponjën që nuk është në pozitën e një mburoje sa është një peshë përgjegjësie, ku mbështetet koka e heroit - meditimi i tij, rreth flamurit pra, rreth atdheut. Heroi këtu nuk është në kulmin e tij.

Tani është i moshuar dhe meditet sa dhe vetë mjekra duket se i mendon diçka, ashtu e mirëmbajtur dhe e krehur që dëshmon edhe për një nge të heroit në meditim, për një duresë për zgjidhjen e pikëpyetjes meditative. Ai sikur ka ndjesinë e një të keqe që kërkon zgjidhje dhe zgjidhja për një çast, duket e fundosur në një mjegull (aziatike) që tinëzisht vjen nga prapa. Vetëm gjysma e djathtë e portretit reflekton dritë mbi pelerinë, por pos subjektit që bartë detaje, hapësira e mbushur ngjyrë mjegulle e furtunë, reflekton në fytyrën e subjektit një seriozitet, që në një mënyrë shpreh mendimet e shumta dhe jo të qarta apo të sigurta për një qëllim. Gjithsesi, autori Agim Sulaj i beson meditimit të kryeheroit, ndaj portretit të tij i jep dritë, i jep mendim dhe reflektim. Ky portret me arritjen e nxjerrjes së psikologjisë në një momentum dileme të kryeheroit, është ndër veprat më të bukura të realizuara nga Agim Sulaj.

(Marrë nga numri i katërt i revistës për kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia")





# Irani, revolucioni nuk gjen paqe edhe pas 40 vjetësh

Në Republikën Islamike, Ali Khamenei mbajti gjallë flakën e revolucionit të ndezur nga themeluesi Khomeini. Tani Trump, nëse përpiket ta shtyjë regjimin, rrezikon të marrë efekt të kundërt: bashkimin e një populli krenar dhe nacionalist

“Çfarë ndien në këtë moment, Imam?” e pyeti një gazetar Ruhollah Khomeini për fluturimin që më 1 shkurt të vitit 1979 e solli atë përsëri në Iran, pas pesëmbëdhjetë vitesh mërgim. Dhe ai u përgjigj: “Hitchi”. Asgjë. Për dyzet vjet është reflektuar mbi kuptimin e asaj përgjigjeje, me interpretime të ndryshme, siç pasqyrohet nga Alberto Zanconato, ish-korrespondent i Ansa nga Teherani, në esenë e tij të freskët të shtypit Khomeini, revolucionar i Perëndisë (Castelvecchi).

Për monarkistët dhe kundërshtarët e tjerë të Republikës Islamike është prova e indiferencës totale për vendin e tyre që çoi në revolucion. Për mbështetësit e tij është konfirmimi i “majave mistike” të cilat Imami ka arritur dhe nga e cila edhe lidhja me tokën amtare ka humbur vlerën, ose ishte një mënyrë për të pohuar se ishte një revolucion për tërë Islamit, përtej kufijve kombëtarë. Sipas Zanconato, megjithatë, ishte vetëm një “predhë që Khomeini kishte ndërtuar në këtë moment vendimtar të sfidës së tij ndaj pushtetit monarkik, kur rezultati ishte ende në ekuilibër”.

Do të ketë shumë histori që do të konkurrojnë me njëra-tjetrën këtë vit, në përvjetorin e dyzetë të Republikës Islamike: përkujtime dhe rrëfime të asaj që ndodhi në vitin 1979, por mbi të gjitha sesi një regjim që shpesh nënvlerësohet nga analistët dhe armiqët, ka qenë në gjendje të rezistojë për dyzet vjet. Ka nga ata që e nisnin Revolucionin Islamik në janar 1978, me botimin e një artikulli kundër Khomeinit, në gazetën qeveritare Ettelaat, i cili e akuzoi atë se ishte një agjent britanik, një aleat i komunistëve dhe insinuo i se ai nuk ishte vërtet iranian dhe se kredencialet e tij fetare ishin të dyshimta. Ky artikulli ishte një siguresë e hedhur në kazanin e pabarazisë sociale, të urrejtjes ndaj shërbimeve brutale të sigurisë dhe të perëndimimit në rritje që kishte skandalizuar konservatorët.


Fetarët e Qom hynë në grevë, pasuar nga tregtarët e pazarit. Protestat u rritën, me slogane kundër monarkisë. Policia hapi zjarrin, së pari në ajër, pastaj në turmë. Çdo funeral u bë një

manifestim i ri, një përshkallëzim që çoi në mërgimin e tij më 16 janar 1979. Më 11 shkurt qeveria e fundit e emëruar nga Pahlavi dha dorëheqjen, me rënien e regjimit monarkik. Goditja përfundimtare u dha nga guerrillasat marksistë, por në muajt në vijim Khomeinistët u riorganizuan dhe në dy apo tre vjet u formua një gjendje klerike që eliminonte një nga një ata që ishin aleatë të revolucionit: marksistët, laikët dhe muslimanët liberalë.

Dyzet vjet më vonë, është e dobishme të fillosh nga Khomeini për një bilanc. Nuk do të ishte e mundur që Irani t'i rezistonte çdo parashikimi të luftës tetëvjeçare me Irakun, në të cilin Saddam Hussein kishte mbështetjen e Perëndimit dhe pothuajse të gjithë botës arabe, pa mbështetjen e një pjese të madhe të popullsisë, veçanërisht masave të rinjve që erdhën për të flijuar qëllimisht jetën e tyre. Nëse e konsideroni Khomeinin një fundamentalist fanatik, një heretik ose një populist, siç shpjegon Zanconato, revolucioni i tij u krye fillimisht brenda Islamit, sipas doktrinës së velayat-e-faqih).

Që nga vdekja e Khomeinit në vitin 1989, Republika Islamike vazhdon të jetë një përzjerje e demokracisë dhe teokracisë dhe pasuesi i saj, Ajatollah Ali Khamenei, vazhdon të përdorë slogane anti-amerikane, por regjimi nuk solli, siç ishte premtuar, fund të pabarazive. Në përpjekje për të ringjallur ekonominë, Irani i ka dhënë fund vetëizolimit: ajo ka ngritur ndalimin revolucionar ndaj investitorëve të huaj në vitin 1995, edhe pse deri tani ka luftuar për të tërhequr investime për periudha të zgjatura. Për dekada të tëra, para dhe pas revolucionit islamik të vitit 1979, Ayatollah Khomeini denoncoi helmimin e shoqërisë nga kultura perëndimore dhe dëboi çdo gjë nga muzika te valëzimi drejt artit modern. Por, që atëherë Republika Islamike është konsumuar nga një përplasje e brendshme e qytetërimeve.

Temat zyrtare të propagandës gjejnë pak dëshmi në një shoqëri të re dhe të globalizuar, me shumë gra të arsimuara, me një kontakt me botën që nuk



mund të ndalet nga filtrat e imponuar në internet. Kështu që regjimi shpesh u detyrua të lirojë kufizimet. Protestat e vitit 2009 kundër rizgjedhjes së presidentit ultrakonservator Mahmud Ahmadinejad treguan se të rinjtë e Teheranit donin të ndryshonin dhe ishin gati të ndiqnin politikanët e moderuar për të ndryshuar sistemin nga brenda: por që Vala e Gjellbër u shtyp me dhunë, duke shënuar një thyerje që ende nuk është mbyllur.

Zgjedhja e Hassan Rouhanit në vitin 2012 premtoi pikërisht ndryshimin e mohuar katër vjet më parë: fundi i izolimit ndërkombëtar nëpërmjet një marrëveshjeje bërthamore me Perëndimin dhe liritë më të mëdha sociale brenda vendit. Këto janë premtime që janë realizuar vetëm pjesërisht, por është e rëndësishme që Khamenei i ka dhënë Rouhanit mbështetjen e nevojshme për të hapur Amerikën, duke treguar një aftësi të caktuar të idealeve revolucionare kur ajo shërben për të parandaluar kolapsin.

Megjithatë, në vitin 2018, korrupsioni i elitës dhe shpenzimet publike në luftërat në Siri dhe Jemen, gjithashtu e shtyu mostazafinin (të varfrit e provincave konservatore dhe të devotshme), që prej vitesh konsiderohej si shtylla kurrizore e regjimit komeinist, katror, i zemëruar me të gjithë politikanët (reformatorët dhe konservatorët) dhe të njëjtin Udhëzues Suprem (“Vdekja diktatorit”), me institucione jo të zgjedhura si Pasdarani dhe fondacionet fetare që mbështeten në buxhete të mëdha, ndërsa njerëzve u janë shkurtuar subvencionet. Dyzet vjet më vonë, ka shumë hipoteza për të ardhmen e Republikës Islamike. Khamenei ishte në gjendje ta mbante flakën e revolucionit të gjallë për tridhjetë vjet pas vdekjes së themeluesit, pavarësisht se nuk kishte karizëm, falë aleancës me konservatorët dhe Pasdaranin. Por, çfarë do të ndodhë kur pishtari do të kalojë tek një pasues i cili nuk ishte ndër “shokët” e Khomeinit? Deri në çfarë mase mund të mbijetojë

fryma e revolucionit në një popullatë që për 70% nuk ka lindur në vitin 1979? Pas ndryshimit të kompanive perëndimore të naftës nga Irani dyzet vjet më parë, Irani ka shkuar nga prodhimi i 10% të naftës botërore në 4%. Marrëveshja bërthamore e kërkuar nga Barack Obama është hedhur poshtë nga Donald Trump dhe sanksionet e reja tani detyrojnë vendet që përdorin sistemin bankar amerikan për të pezulluar blerjen e naftës irani-ane.

Për Republikën Islamike nuk është hera e parë: tashmë e njeh luftën dhe izolimin. Nëse Trump dhe këshilltarët e tij shpresojnë të fusin regjimin, ekspertët paralajmërojnë se sjellja agresive mund të ketë efekt të kundërt, duke bashkuar një popull krenar dhe nacionalist. Unë kam ndjekur Iranin për dhjetë vjet për Corriere della Sera, por kurrë nuk kam harruar diçka që më ka shkruar pikërisht Zanconato, para se të shkojë në Teheran për herë të parë: mendoni për atë që doni prej tyre, por mos i nënvlerësoni ato kurrë.

(gazeta-Shqip.com)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LEEDS - DERBY

1

LYON - REIMS

1

CLERMONT FOOT - CHAMOIS NIORT

1

## Drita huazon mbrojtësin e Prishtinës, Përparim Osmanin

GJILAN, 10 JANAR (ER) - Prishtina dhe mbrojtësi i krahut të djathtë, Përparim Osmani, kanë ndarë rrugët, por vetëm përkohësisht. Mbrojtësi 30 vjeç ka kontratë me Prishtinën deri në qershor, por angazhimi i vogël me ekipin e parë ka bërë që futbollisti të kërkojë të lirohet. Klubi bardhekalër ia ka plotësuar dëshirën dhe Osmani në pjesën pranverore do të luajë te kampioni aktual i Kosovës, Drita. "Nuk ka qenë e lehtë, aspak e lehtë, që të largohem nga një klub shumë mirë i organizuar me një kolektiv shembullor. Mirëpo futbollit i ka këto gjëra dhe besoj se nuk ka asnjë të keqe, sepse të dyja palët kemi qenë shumë korrekte. Te Prishtina kam kaluar çaste jashtëzakonisht të mira dhe jam krenar që kam qenë pjesë e Prishtinës, sidomos në paraqitjet dy vjet rresht në Evropa Ligë. E falënderoj udhëheqjen e klubit, stafin e trajnerëve dhe të gjithë bashkëlojtarët për çastet e mira të kaluara për një vit e gjysmë



duke iu dëshiruar sukses dhe më në fund ta rikthejnë sërish titullin e kampionit në krye-

qendër", ka thënë Përparim Osmani për faqen zyrtare të Prishtinës.

## Drenica huazon katër lojtarë nga Feronikeli

SKENDERAJ, 10 JANAR (ER) - Kryesia e re e Drenicës ka vazhduar përfundimisht për stinorin pranveror, me ç'rast ka prezantuar katër lojtarë. Bëhet fjalë për Argjend Bardhin, Diar Prokshin, Nicolas Andrews dhe Prince Balden, që të tre të ardhur nga Feronikeli si huazim. "Në stërvitjen e ditës së mërkurë ekipit i janë bashkuar edhe katër futbollistë Argjend

Bardhi, Diar Prokshi, Nicolas Andrews dhe Prince Balde. Katër futbollistët janë huazuar nga skuadra e Feronikelit me mundësi blerje në qershor. Klubi do të vazhdojë ta përfundojë ekipin për pjesën e dytë të kampionatit", thuhet në njoftimin e klubit kuqez. Drenica është eliminuar nga Kupa, ndërsa në pranverë do të kërkojë që sa më parë ta sigurojë mbijetesën.



## Amir Prishtina nënshkruan me KEK-un


OBILIQI, 10 JANAR - Amir Prishtina është lojtari më i ri i klubit futbollistik nga Obiliqi, KEK-u. Klubi i Futbollit KEK-u ka vazhduar serinë e përfundimeve në afatin kalimtar dimëror, para fillimit të sezonit pranveror në Superligë. Ekipi nga Obiliqi të enjten ka zyrtarizuar edhe transferimin e pestë në këtë mini-afat. Është djaloshi nga Vushtrria, Amir Prishtina, i cili ka nënshkruar kontratë me KEK-un. Lajmin për transferimin e Prishtinës e ka konfirmuar vetë kryetari i klubit nga Obiliqi, Besnik Mjeku. "Amir Prishtina është lojtar i ri i KEK-ut. Kemi nënshkruar marrëveshje për gjashtë muaj", ka thënë Mjeku për



"Telegrafin". Prishtina në të kaluarën ka luajtur edhe për Trepçën dhe Vushtrinë, aty ku ishte edhe tani së fundmi.

## Federeri zbulon një nga sekretet e jetëgjatësisë dhe suksesit të tij

BERN, 10 JANAR - Falë një formë fizike për t'u pasur zili, që ka qenë thujse e njëjtë përgjatë dy dekadave të fundit, tenisti zviceran Roger Federer ka arritur të jetë dominues në fushë edhe pse aktualisht është 37 vjeç. Në prag të Australian Open, ku do ta mbrojë titullin e fituar vjet, numri tre në botë sqaron: "Kam qenë me fat, pasi nuk u jam nënshtruar ndërhyrjeve kirurgjikale, veç në vitet e fundit", ka thënë Federeri. "Gjithnjë kam marrë vendime të mira për sa i përket karrierës time, përfshirë edhe atë që të bashkëpunoj me Pierre Paganini, me të cilin stërvitem prej 20 vjetësh. Gjithnjë kam qenë i kujdesshëm për sa i përket regjimit të fitnesit, edhe kur isha adoleshent, çka më ndihmoi të kem këtë jetëgjatësi në sport.



Mendoj se e kuptoj mirë trupin tim, e di kur kam ndonjë dhimbje të lehtë apo kur ajo është e

rëndë. Di si ta menaxhoj situatën për ta evituar çdo problem në fushë", ka thënë Federeri.

## Hazardi kërkohet nga katër klube të mëdha evropiane

Thorgan Hazard dëshiron të largohet nga Borussia Monchengladbach, pasi dëshiron të luajë te një klub më i

madh. Anëtori belg është bërë cak i shumë skuadra evropiane, ndërsa klubi gjerman i do 50 milionë euro nga shitja e tij.

Dortmund, Liverpool, Inter dhe Roma duan ta transferojnë Thorgan Hazardin në këtë afat kalimtar të janarit. Belgu ia ka

bërë me dije Borussia Monchengladbachit se ai do të largohet në këtë afat, edhe pse ata refuzojnë shitjen e tij.





	<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)	SHUMË, TEJ MASE	PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.)	UNIVERSITY LANCASTER OHIO	TINARI	<b>EPOKA E RE</b>	SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA	ZANORE	GUR I ÇMUAR MË NGJYRË TË KALTËR OSE TË GJELBËR	PIANISTJA LULE .....	KËNGËTARJA ..... MUÇAJ	
	LËNG I TRASHË VESHTULLOR QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTAËS							PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLU-AR UJË BASHKËT.					
	KËNGËTARJA ..... EMINI								PËRGJIGJE NË TELEFON E GDHENDA				
	SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE							ARBITËR BEREQET					
	LETRARI ASLLANI					METODË STUDIMI PËRSHTATJE (sh.shq.)							
	VETIA THELBËSORE E QENIEVE TË GJALLA						FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË SHTET FEDERAL NË SHBA						QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE
	KALË SHALE				THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.) "KENIA"					GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)	ZANORE GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË		
BASHKËT.			PJESË E FORTË E BUKËS "RISANI"					LLOJ BIME ME TË CILAT BËJMË PILAF					
<b>EPOKA E RE</b>	LOJ PËLHURË E TRASHË SI STOF	QË I MOHON NORMAT E MORALIT	AKTORJA E FAMSHME ANDERSON	VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU LLOJ LOJE FATI	MURG I VETMUAR AMPER, RENUIM				DALLGA SHOK				
DAMARI I GJAKUT													
DILETANTI												GABZHERRI, GURMAZI	
BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË PËRDORET SI USHQIM						FUTBOLLISTI ..... XHEKO FUTBOLLISTI SENEGALEZ ARMAND ..... (QPR)				GJAKATAR KUVENDI I KOSOVËS			
AKTORJA ..... PAPAS					KËRCËLL I BIMËS SË MISRIT ZANORE					SHKRONJË GREKE NDODHEM RASTËSISHT NË NJË VEND			
DHUROJ DIÇKA				RANISHTJA PËSHTJELIM (shq.)			ZANORE I AFRUAR		GRYKË E VULLKANIT LECKA PËR ARNIM				
HOVI, VRULLI					KËNGËTARJA AMERIKANE ..... BAKER BASHKËT.				ANGOLA, ZAMBIA ZANORE		TITAN VAJZA E DJALIT A E VAJZËS		
<b>EPOKA E RE</b>	SHKRIMTARI ..... HAZIRI	I PARI I MURGJVE NË NJË ABACI (pashq.)	BASHKËT. KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP E ME QAFË TË TRASHË	KLUB FUTBOLLI NË HOLANDË, RADIUM, ZET			HUMORISTI ..... THAQI PJESË E ILIRISË					BASHKËT. SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË (bised.)	
RADIOLOKATOR					BIMË E CILA PËRDORET PËR USHQIM RAPSODI BERISHA (shq.)				BASHKËT. ROMANCIERI GJERMAN ERIK MARIA		KËNGËTARJA JONË '... MAMA'		
LIBËR FILLESTAR											ISH FUBOLLISTI BRAZILIAN ... GASPÀR (ARSENAL) VEZAK		
ÇMENDURI; BUDALLALLËK						BABAI AMERICAN TEATRE ORGAN SOCIETY			E BITISA I NDESH			VEZË PESHKU (shq.)	
ARTIOLA TOSKA			BASHKËT. BUILDING INFORMATION MODELING	REGJISTRIM NË FATURË I ÇMIMIT TË NJË MALLI SIENA						KAPI DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE TEXAS EDUCATION AGENCY			
BASHKËT.		BESËLIDHËS RAMADAN AVDIU										ERNEST KOLIÇI AFËRDITA DRESHAJ	
KLUB FUTBOLLI NË GREQI					BASHKË, ME TOTENHAM							BASHKËT. ZANORE	
PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE												DËSHIROJ	
						MBULESA QË E VË DIKUSH NË FYTYRË PËR TË MOS U NJOHUR NGA TË TJERËT							





Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance  
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



## Njoftim për tatimpagues

### Regjistrimi i Mallrave në Stogë

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se në bazë të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, tatimpaguesit duhet të regjistrojnë mallrat në stogë në fund të vitit kalendarik. Regjistrimi i tillë duhet të jetë i gatshëm më së largu deri me datën 10 Janar të vitit 2019.

Çdo tatimpagues, pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrave të parapara me ligj, kërkohet të kryejnë regjistrimin e mallrave në stogë në fund të vitit kalendarik.

Regjistrimi i tillë, duhet të përfundohej më, apo para datës 10 Janar të vitit vijues dhe të jetë në dispozicion për inspektim me kërkesën e Administratës Tatimore të Kosovës.

Shënimet e regjistrimit të mallrave, përfshijnë treguesit vijues:

Nr.	Emërtimi mallit	i Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Vlera

Regjistrimi i mallrave duhet të mbahet me çmimin e koston.

Administrata Tatimore e Kosovës, i rikujton të gjithë tatimpaguesit, të cilët nuk respektojnë afatin e paraparë për të regjistruar mallrat në stogë, se do të jenë objekt i masave ndëshkuese të parapara me Legjislacionin Tatimor të Kosovës.

**Administrata Tatimore e Kosovës**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “BACARDI CLUB” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810174912 me pronar Petrit Azemi dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BACARDI CLUB ” D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810174912 ujedno imenovao Petrit Azemi, Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “BACARDI CLUB “ L.L.C in Vushtrria, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit:810174912, Petrit Azemi the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.







NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" S.H.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Ndërmarrja Hidroekonomike, Ibër-Lepenc S.H.A. – Prishtinë, publikon këtë:

## KONKURS

### 1. Zyrtar për trajnime (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë së këtij zyrtari do të jenë si vijim:

- Në koordinim me Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore harton planin vjetor të trajnimeve;
- Është përgjegjës për kompletimin dhe ruajtjen e dosjeve të trajnimeve;
- Evidenton në dosje të personelit të gjitha trajnimet e mbajtura;
- Përkujdeset për pjesëmarrjen e Zyrtarëve të Ndërmarrjes në trajnime;
- Mbanë kontakte me Qendrat e Trajnimeve;
- Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me natyrën e punës së tij/saj
- Për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të Administratës;

**Marrëdhënia e punës:** Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimtë.

#### Kushtet:

- Diplomë Universitare drejtimi ekonomik ose juridik;
- Përvoja e punës së paku 2 (dy) vite ;
- Njohuri e programeve kompjuterike;
- Njohja e gjuhës angleze do të jetë përparësi;

### 2. Punëtor në mirëmbajtjen e rrjetit të ujitjes në Njësinë Punuese "Shkabaj" (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë së këtij zyrtari do të jenë si vijim:

- Kryen të gjitha punët për mirëmbajtjen e objekteve për ujitje dhe kullim;
- Viziton objektet dhe varësisht nga nevoja intervenon në evitimin e defekteve;
- Punon në sanimin e pjesëve të dëmtuara në rrjetin për ujitje dhe objekte tjera që i takojnë natyrës së punës së tij;
- Punon në mbushjen, ajrosjen dhe zbrazjen e rrjetit për ujitje;
- Mbikëqyrë dhe evidenton shfrytëzimin ilegal dhe rastet ia paraqet me shkrim udhëheqësit të njësisë punuese;
- Punon në mbrojtjen e pajisjeve dhe objekteve të ndërmarrjes;
- Punon në pastrimin e kanaleve ekzistuese dhe ndërtimin e të reja;
- Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe veglave të punës;
- Punon dhe punë tjera me urdhërin e udhëheqësit;
- Për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Njësisë Punuese dhe Drejtorit të Njësisë Afariste.

**Marrëdhënia e punës:** Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimtë.

#### Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;

### 3. Punëtor në bufe (1)

Detyrat dhe përgjegjësitë së këtij zyrtari do të jenë si vijim:

- Ofron pijet të ngrohta dhe të ftohta në bufe dhe zyre;
- Kujdeset për furnizimin me kohë të bufes me materialct të nevojshme;
- Mban higjienën e pajisjeve dhe të inventarit të bufes;
- Mban evidencat e nevojshme për këtë vend pune;
- Aplikon masat e mbrojtjes në punë;
- Kryen edhe punë tjera, të kërkuara nga eprori, të cilat i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale dhe aftësive të fituara me punë, të cilat kanë të bëjnë me natyrën e punëve të këtij vendi të punës;
- Për punën e vet i raporton dhe përgjigjet Shefit të logjistikës dhe Drejtorit të Administratës.

**Marrëdhënia e punës:** Në kohë të caktuar deri në një vit, me punë provuese deri në 6 muaj, me mundësi të vazhdimtë.

#### Kushtet:

- Përgatitja e mesme shkollore;
- Të ketë aftësim për ofrimin e shërbimeve në bufe.

#### Kërkesës për pozitat e kërkuara t'i bashkangjitet:

- CV;
- Diplomën;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Dëshmitë për kualifikimet plotësuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Certifikata që nuk është nën hetime;
- Fotokopja e letër njoftimit;

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ndërmarrjes [www.iber-lepenc.org](http://www.iber-lepenc.org).

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas konkursit dorëzohen në Drejtorinë Qëndrore të N.H., Ibër-Lepenc – Prishtinë ose përmes postës.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Me kandidatin e zgjedhur do të nënshkruhet Kontrata e punës pas sjelljes së certifikatës mjekësore.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ylber Plakiqi shpallë të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik të UP-së, Prishtinë me nr. 2282 të datës 12.03.2012.

► Djellza Balidemaj e shpalli të pavlefshme diplomën baçelor te Fakulteti te Psikologjise te Kolegjit AAB.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Trullin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë, në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.



# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

